

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7732 E shtunë 8 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Studentët protestues bënë mirë që Spërzunë drejtues të opozitës, pasi nuk ka asgjë politike në shqetësimet e tyre. Tarifat e universiteteve publike janë caktuar ...
Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI
Jo arsimit të lartë publik bankomat


Opinion *i* **Ditës**
Ju pastë nëna!- Iu thotë studentëve çdo gjyshe si unë e çdo nënë brënda e jashtë Shqipërisë edhe nëse nipi apo djali i tyre nuk është në shesh prej detyrimit të jetës ...
Vijon në faqen 21

Nga LILIANA HOXHA
Zëri i Shqipërisë




Udhëtoi 1 orë me kalë nga fshati

Drama e gruas, aborton trinjakët. E ëma: Bulqiza nuk ka gjinekolog

31-vjeçarja, në muajin e pestë të shtatzënisë. Ministria: Mjekët nga Tirana i shpëtuan jetën

ENVER DOÇI

BULQIZË-Një 31-vjeçare nga një fshat i thellë i Bulqizës dhe që ishte në muajin e pestë të shtatzënisë pasditen e djeshme ka humbur trinjakët e saj. Behet fjalë për Enkeleda Rexhepin, që udhëtoi për një orë në kalë e më ...
Në faqen 9

PROTESTA/ MIJERA TE RINJ TE MINISTRIA E ARSIMIT: 8 KERKESAT TONA

STUDENTET: S'TERHIQEMI. RAMA: JU PRES NE ZYRE

Reagimi i të rinjve përhapet edhe në rrethe. Nikolla, letër studentëve: Karta e studentit, e bëjmë brenda vitit 2019. Rama: Dua t'ju dëgjoj



(Në foto) Studentë duke protestuar përpara Ministrisë së Arsimit, ku kanë kërkuar përgjysmimin e tarifave të shkollimit

NGRIHET KESHILLI
Hidhet shorti për emërimet në drejtësi, PD: Procesi është i jashtëligjshëm
Në faqen 7

GJERMANI
Angela Merkel ikën pas 18 vitesh nga drejtimi i CDU: Koha për kapitull të ri
Në faqen 12

HAPAT DHE KOSTO
Legalizimi i dokumenteve në ambasadën italiane, ndryshon procedura
Në faqen 10

"BLUETOOTH"
Finalja 2018, kush janë pretendetët për të fituar Këngën Magjike
Suplement

UNIVERSITETI



Pedagogia e njohur amerikane, leksion i hapur te 'Luarasi' për drejtësinë
Në faqen 11

Dokumenti/ Firma fituese e 18 milionë eurove falsifikoi datën e themelimit

Skandali me tenderin e Unazës, SHBA nis hetimin

Autoriteti Rrugor pezullon ndërtimin. Heton edhe prokuroria e Tiranës

Shqipëria përballet me një tjetër skandal korrupsioni, që ka të bëjë me një prej kompanive që ka fituar tenderin për një prej segmenteve të Unazës së Madhe në Tiranë. Kompania shqiptare funksionon si degë e një kompanie të regjistruar në shtetin Delaware në Shtetet e



Bashkuara. Zyra e sekretarit të shtetit në Delaware konfirmoi për "Zërin e Amerikës" se ka filluar hetimet për të përcaktuar nëse kompania "Dunwell Haberman", ose ndonjë prej zyrtarëve të saj është përfshirë në aktivitete të paligjshme, mashtrime ose ...
Në faqen 3

UNAZA E MADHE SKANDALI



Kreu i PD: Në tenderin korruptiv, të përfshira të gjitha institucionet e shtetit

"Unaza", Basha: Projekti, pastrim ndërkombëtar parash

"Duan të vjedhin 18 mil euro në dorë"

Valentina Madani

Banorët e Unazës së Re në kryeqytet dolën sërisht dje në protestë, duke kundërshtuar prishjen e banesave të tyre, siç e parashikon projekti për Unazën e Madhe. Në ditën e 34-të të protestës, banorët janë vendosur në dy anët e rrugës pranë mbikalimit të pallati me shigjeta, duke bllokuar qarkullimin e mjeteve. Paralelisht me atë në Unazën e Re, protesta u zhvillua edhe në Shkozë, ku banorët bllokuan rrugën. Ata janë kundër prishjes së banesave të tyre, siç e parashikon projekti për ndërtimin e Unazës së Madhe. Banorët bllokuan qarkullimin e automjeteve, si dhe u vunë flakën kuzhinave të plehrave. "Duam shtëpitë tona! Nuk duam probleme me policinë! Duam dëmshtëpërim!" tha një prej banorëve. Tashmë me pezullimin e punimeve për lotin nr.1 të segmentit të Unazës së Madhe, që shtrihet nga Ura e Lanës deri te mbikalimi i sheshit "Shqiponja", banorët e "Astitrit" ishin më të motivuar në ditën e 34 të protestës së tyre.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

AKUZA
"Është e qartë për të gjithë se projekti i Unazës është një vjedhje dhe jo një zhvillim. Sot të gjithë po shohin Ramën e vërtetë pa maskë dhe fasadë. Arroganca, dhuna dhe këmbëngulja mizore dymujore për të nxjerrë nga shtëpitë qytetarët frymëzohet nga makutëria për para. Ne kemi dy muaj që e themi çdo ditë këtë gjë, pavarësisht se helmimi i propagandës i ka penguar qytetarët të shohin të vërtetën", - tha Basha.



Fakimile e dokumenteve të publikuara në emisionin "Të Paespozuarit"

MBËSHËTETJA

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, iu bashkua sërisht dje protestës së banorëve të "Astitrit" kundër shembjes së shtëpive të tyre nga projekti i Unazës së Re. Pasi Prokuroria nisi hetimet lidhur me tenderin për këtë projekt, lideri demokrat tha se një gjë të tillë PD e ka paralajmëruar që prej dy muajsh se ishte një projekt vjedhjeje e jo zhvillimi. Sipas tij, ky projekt është pastrim ndërkombëtar parash. "Donte të vidhte 18 milionë euro për t'i çuar në Amerikë. Se çfarë do të bënte me këto para, do ta marrim vesh edhe këtë. Qëndresa dhe bashkimi funksionojnë dhe e zmbarsin hajdutërinë. Zgjidhja politike është ngritja dhe bashkimi i qytetarëve për të shembur këtë sistem që nuk ka asnjë lidhje as me demokracinë dhe as me ekonominë e tregut", tha Basha. Ai akuzoi se në tenderin korruptiv janë të përfshira të gjitha institucionet e shtetit. "E vërteta triumfoi, vjedhje dhe pastrim parash ku janë përfshirë të gjithë institucionet e shtetit, prokurimet publike, ARRSH, Ministria e Transportit, Bashkia e Tiranës, Policia Ndërtimore. Të gjithë këta bashkë i lidh Edi Rama. Do jemi në krah të këtyre njerëzve derisa të garantojmë të drejtat e tyre, shtëpitë e tyre, anulimin dhe hetimin e plotë të këtij tenderi korruptiv dhe vënien para ligjit të gjithë personave përgjegjës nga kryeministri deri te nëpunësi më i

Skandali me Unazën, Kryemadhi: Prokuroria të hetojë projektin famëkeq

Kryetarja e LSI, Moni Kaka Kryemadhi, i bëri dje thirrje Prokurorisë të nisë hetimet për projektin e Unazës së Madhe. Duke iu referuar dokumenteve të publikuara në emisionin "Të paespozuarit" në "News 24" për kompaninë që ka fituar tenderin që ka falsifikuar firmën e sekretarit amerikan të shtetit, Kryemadhi tha se janë provat e mjaftueshme për prokurorinë. "Banorët e Unazës së Re i ka bërë pronarë ligji i 2006-ës, të cilin ne si institucione e si politikë e kemi shkëlur me të dyja këmbët. Pabarazia para ligjit quhet diskriminim. Kjo është qeveria që bën qeverinë më të mundshme raciste që kemi parë në këto 27 vjet. Tenderi i Unazës së Re që dje u fak-



tua nga një emision ku kish të falsifikuar firmën e sekretarit të shtetit, tregon se ka kaluar çdo shkallë dhe çdo normë morale dhe ligjore të kësaj qeverie. Tenderi i Unazës së Re jo vetëm që është një vepër korruptive, por është një ndasi sociale që përbën diskriminim. Prokuroria e ka veprën penale dhe nuk ka më çap për të filluar hetimin e kësaj vepre

korruptive, diskriminuese që është bërë ditën me diell. Prokuroria ka përpara korupsionin e tenderit, dokumente të falsifikuara, prandaj nuk mbetet gjë tjetër që të tregojë angazhimin e saj për të treguar që ne kemi bërë reformë në drejtësi", theksoi Kryemadhi. Sipas saj, shpërblimi i drejtë sipas ligjit është më e pakta që mund të bëjë qeveria shqiptare. "Nuk kemi parë e dëgjuar që një projekt për 2.3 km rrugë kushton 48 mln euro dhe ka zero dëmshtëpërim për banorët. Prokuroria të nisë procedim penal ndaj të gjithë hartuesve të këtij projekti famëkeq. Iu bëj thirrje të gjithë atyre që janë të përfshirë në këtë zullum të kthejnë sytë nga qytetarët", tha Kryemadhi.

thjeshtë dhe çdo person tjetër i përfshirë në këtë aferë të tmerrshme", deklaroi z.Basha. Më herët nga selia blu, z.Basha kërkoi që Autoriteti Rrugor Shqiptar të dalë para drejtësisë, ndërsa sipas tij, faktet e publikuara i nxorën maskën e vërtetë të Edi Ramës. "Është e qartë për të gjithë se projekti i Unazës është një

vjedhje dhe jo një zhvillim. Sot të gjithë po shohin Ramën e vërtetë pa maskë dhe fasadë. Arroganca, dhuna dhe këmbëngulja mizore dymujore për të nxjerrë nga shtëpitë qytetarët frymëzohet nga makutëria për para. Ne kemi dy muaj që e themi çdo ditë këtë gjë, pavarësisht se helmimi i propagandës i ka penguar qytetarët të shohin

të vërtetën. Sot të gjithë po shohin Ramën pa maskë, një hajdut që për të mbushur xhepat e tij është i gatshëm të flakë në rrugë pleq e fëmijë. Mbrëmë këto fakte tronditëse u shfaqën në emisionin "Të Paespozuarit". ARRSH e Ramës duhet të dalë e gjitha para drejtësisë. Të gjitha koncesionat janë akta korruptivni", - tha Basha.

Skandali me tenderin, Nishani: Gangsterizëm shtetëror

Ish-presidenti Bujar Nishani iu bashkua dje reagi lmeve pas skandalit të publikuar nga emisioni "Të Paespozuarit", në lidhje me kompaninë që ka fituar tenderin e Unazës së Madhe, duke falsifikuar firmën e sekretarit amerikan të shtetit. Nishani thekson se kjo është prova skandaloze se si kjo kompani ka përfituar 40 milionë euro për 2.2 km rrugë tek Unaza e Re. Ai shtoi se, "ky denoncim na provoi se kemi të bëjmë me gangsterizëm shtetëror". "Këto dokumente të falsifikuara jo vetëm janë paraqitur nga mashtruesit, por edhe kanë kaluar, pranuar e miratur nga pushtetarët. Që kjo ishte një vjedhje, kjo u mor vesh që kur u mësuua se do paguheshin 40 milionë euro për 2 km rrugë", tha Nishani.



Unaza, Shehaj: Veprimi i ARRSH manovër, prokuroria të hetojë

Deputeti i PD, Agron Shehaj reagoi dje lidhur me vendimin e ARRSH për pezullimin e ndërtimit të lotit të parë të Unazës së Madhe. Shehaj e konsideron vendimin një manovër të ARRSH, ndërsa kërkon nga Prokuroria të nisë menjëherë hetimet. "Vendimi i ARRSH-së është një manovër mashtruese për të shpëtuar hajdutët. Drejtori i ARRSH-së dhe i gjithë stafi drejtues duhet të pezullohen menjëherë nga detyra dhe të merren nën hetim menjëherë nga prokuroria. Të gjitha dokumentet e tenderit dhe të projektit duhet të sekuestrohen menjëherë që të mos manipulohen dhe tjetërsohen. Këto janë veprimet më minimale. Hetimi duhet të përfshijë edhe kompanitë Edi Rama Invest dhe Erion Veliain Invest, që janë autorët dhe përfituesit e kësaj megavjedhjeje", shkruan Shehaj.





"Dunwell Haberman", pas akuzave për korrupsion: Po monitorojmë zhvillimet në Tiranë

Skandali me tenderin tek Unaza, SHBA nisin hetimet ndaj firmës 'DH'

Hije dyshimi mbi një nga firmat fituese

Shqipëria përballet me një tjetër skandal korrupsion, që ka të bëjë me një prej kompanive që ka fituar tenderin për një prej segmenteve të Unazës së Madhe në Tiranë. Kompania shqiptare funksionon si degë e një kompanie të regjistruar në shtetin Delaware në Shtetet e Bashkuara. Zyra e sekretarit të shtetit në Delaware konfirmoi për "Zërin e Amerikës" se ka filluar hetimet për të përcaktuar nëse kompania "Dunwell Haberman", ose ndonjë prej zyrtarëve të saj është përfshirë në aktivitetet të paligjshme, mashtrime ose falsifikime.



SHKURTE

Skandali i mashtrimit me tenderin për Unazën, prokuroria nis hetimet

Pas emisionit "Të Paeksportuarit", transmetuar të enjten në mbrëmje në "News 24", Prokuroria e Tiranës nis hetimet në lidhje me faktet e bëra publike, lidhur me tenderin për Unazën e Re. Organi i akuzës bën me dije se po heton mbi faktet e bëra publike për ndërtimet e planifikuara në Unazën e Re. Verifikimi bëhet për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës", "Falsifikimi i dokumenteve", "Shkelje e barazisë në tendera", "Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë po kryen veprimet hetimore, në lidhje me faktet e bëra publike mbi rregullshmërinë e veprimeve të kryera për ndërtimet e planifikuara në Unazën e Re. Verifikimi bëhet për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, "Shkelje e barazisë në tendera", parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal", - njofton organi i akuzës. Prokuroria shqiptare garanton vlerësimin me objektivitet të fakteve, objekt i këtij hetimi, duke kryer veprimet hetimore brenda një afati të arsyeshëm.

Mashtrimi me tenderin, ARRSH pezullon ndërtimin e lotit të parë

Pas megaskandalit të publikuar nga emisioni "Të Paeksportuarit", në lidhje me falsifikimet e kompanisë "Dunwell Haberman" (kompania mëmë e "DH Albania"), fituese e lotit të parë prej 18 milionë euro për rindërtimin e Unazës së Madhe, Autoriteti Rrugor Shqiptar urdhëroi pezullimin e aktivitetit ndërtimor për lotin Nr.1 të segmentit, që shtrihet nga Ura e Lanës deri tek mbikalimi i sheshit "Shqiponja". "Në funksion të sqarimit të plotë të situatës dhe pretendimeve të shfaqura në emisionin "Të Paeksportuarit" janë ndërmarrë këto veprime: Deri në sqarimin e situatës dhe përgjigjen nga autoritetet amerikane nuk do të vijohet me aktivitetin ndërtimor të kësaj kompanie për lotin Nr.1 të segmentit, që shtrihet nga Ura e Lanës deri tek mbikalimi i sheshit "Shqiponja". Në rast se autoritetet amerikane do të konfirmojnë zyrtarisht pretendimet për falsifikime dokumentacioni nga kjo kompani, në zbatim të përcaktimeve ligjore, Autoriteti Rrugor Shqiptar do të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme dhe do ndjekë procedurat e tjera të përcaktuara në ligj. Në rast të zgjidhjes së kontratës, ARRSH do të rifillojë menjëherë procedurat e prokurimit për këtë lot, për të mundësuar përfundimin në kohë të këtij projekti të rëndësishëm për kryeqytetin", thuhet në reagimin e ARRSH.

Firma "Dunwell Haberman" vepron në Shqipëri përmes filialit të saj vendës "DH Albania", e cila ka fituar një tender prej rreth 20 milionë dollarësh për një prej segmenteve të Unazës së Madhe në Tiranë. Firma dyshohet se ka kryer dy falsifikime për të siguruar kontratën në Shqipëri. Ka falsifikuar datën e krijimit. Në Delaware kompania figuron e regjistruar para 6 muajsh, në 25 qershor 2018, ndërsa në Shqipëri ka depozituar dokumente, sikur ekzistonte që nga qershori i 1998. Dokumenti i dytë, që dyshohet të jetë falsifikuar është një certifikatë e sekretarit të shtetit se kjo firmë nuk i ka detyrime fiskale shtetit. Zëdhënësi i sekretarit të shtetit, Doug Denison, i tha "Zërit të Amerikës" se për certifikatën nuk ka pasur asnjë kërkesë nga firma dhe as nuk është lëshuar ndonjë dokument. Dokumentet e falsifikuaru dolën për herë të parë në Shqipëri mbrëmë, gjatë emisionit "Të Paeksportuarit", në televizionin "News 24". Sipas zëdhënësit, çështja pritet t'i kalojë për hetime penale zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në Daleaëre, që drejtohet nga Matt Denn. Nëse autoritetet gjejnë shkelje, firmës mund t'i anulohet regjistrimi si biznes në këtë shtet dhe ndaj saj mund të ngrihen akuzat kriminale. Meqë kompania ka aktivitet në një vend tjetër jashtë Shteteve të Bashkuara, rasti mund t'i referohet për ndjekje edhe Departamentit të Drejtësisë në Washington.

REAGIMI

Pas akuzave për korrupsion, reagoi vetë kompania "Dunwell Haberman LLC" (Delaware), që funksionon si degë e një kompanie të regjistruar në shtetin Delaware në

"Të Paeksportuarit", zbulohet mashtrimi me tenderin e Unazës së Tiranës

Emisioni "Të Paeksportuarit" zbardhi një megaskandal, lidhur me kompaninë "Dunwell Haberman" (kompania mëmë e DH Albania) e cila është fituese e lotit të parë prej 18 milionë euro për rindërtimin e Unazës së Madhe. "Të Paeksportuarit" në "News 24" arriti të zbulojë skandalin mbi falsifikimin e firmës nga ana e kompanisë fituese për lotin e parë të Unazës së Madhe. Kjo kompani ka depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri, një letër nga sekretari i shtetit të Delaware, Jeffrey Bullock, për të vërtetuar se kompania është themeluar në vitin 1998. Por, "Të Paeksportuarit" zbuloi se ky dokument është i falsifikuar. Pas një kontaktimi me Departamentin e Shtetit të Delaware, për të vërtetuar autenticitetin e dokumentit që ka depozituar në Shqipëri kompania "offshore", përgjigja ishte: "Pas konsultimit me Departamentin e Korporatave të Delaware, unë mund t'ju deklaroj se dokumentet që ju



na keni dërguar nuk janë autentike dhe nuk e kanë origjinën nga zyra e sekretarit të shtetit të Delaware. Nga të dhënat e gjurmimit të brendshëm, nuk u gjet asnjë dokument për vërtetimin e gjendjes së entitetit në Delaware, të cilit i referoheni (Dunwell Haberman LLC), që të jetë lëshuar në datën ose rreth datës së shënuar në dokument. Për më tepër, vërtetimet për gjendjen e kompanive të cilat Departamenti i Korporatave lëshon, nuk kanë përmbyjtje të njëjtë me dokumentet të cilat na keni dërguar. Gjithashtu, dokumentet që ju na keni paraqitur theksojnë se 'Dunwell

Haberman LLC' është krijuar në 25 qershor 1998. Të dhënat e Departamentit të Korporatave tregojnë se ky entitet është krijuar në 25 qershor 2018, sipas të dhënave publike, bashkëngjitur kësaj letre. Datat dhe numrat e verifikimit, gjithashtu janë ndryshuar në disa vende në dokumentet që ju keni dërguar. Brenda mundësive tuaja, ju lutem më dërgoni informacion lidhur me burimin e këtij informacioni mashtrues. Doug Denison, drejtor i Marrëdhënieve me Komunitetin e Shtetit të Delaware".

Shtetit e Bashkuara. Në një njoftim të siguruar nga "Balkan Web", kompania shprehet se është në përputhje të plotë me rregullat dhe procedurat ligjore dhe administrative vendore dhe ndërkombëtare. Dokumentet e falsifikuaru dolën për herë të parë në Shqipëri mbrëmë, gjatë emisionit "Të Paeksportuarit", në televizionin "News 24". "Dunwell Haberman" LLC (Delaware) është në përputhje të plotë me rregullat dhe pro-

cedurat ligjore dhe administrative vendore dhe ndërkombëtare. Këshilltarët tanë të brendshëm dhe të jashtëm po monitorojnë nga afër zhvillimet në Tiranë dhe janë të gatshëm të ndërmarrin veprimet e duhura nëse kërkohet. Aktualisht po vlerësojmë dokumentet në mediat lokale dhe jemi të vendosur të hedhim dritë mbi pretendimet e parashtruara ndaj "Dunwell Haberman LLC" (Delaware) dhe palët tona të interesit.

Kompania jonë është e hapur dhe e gatshme të bashkëpunojë me autoritetet lokale për të pastruar emrin e saj. "Dunwell Haberman LLC" (Delaware) është një automjet për qëllime të veçanta (SPV) i strukturuar posaçërisht për sipërmarrjet ose investimet në rajonet me ekspozim të lartë të rrezikut, siç janë disa vende të Evropës Juglindore", thuhet në reagimin e kompanisë "Dunwell Haberman".

PROTESTA E STUDENTËVE KËRKESAT DHE THIRRJET

Sot sërish protestë, do mënjanohet çdo përpjekje që përzien kauzën me politikën

Dhjetori i dytë, mijëra studentë në protestë: Lindita, dil në bulevard

"Po nuk ra tarifa e shkollës, do bjerë ministria"

Voltiza Duro

Mijëra studentë kanë protestuar sërish ditën e djeshme për plotësimin e kërkesave të tyre, paraqitur Ministrisë së Arsimit. Ndërkohë, edhe sot në orën 9.30 ata do të marshojnë sërish pranë korpusit universitar, duke theksuar se do të mënjanohet çdo përpjekje për ta përzier kauzën studentore me politikën. "Dhjetori i dytë! Jo negociata, vetëm plotësim të kushteve. Studentë, maturantë, prindër, të gjithë të bashkuar për të kërkuar me ngulm plotësimin e kushteve. Të gjithë studentët e universiteteve të rretheve të mblihen dhe të protestojnë pranë universiteteve të tyre si dhe të vijë kush ka mundësi në Tiranë. Kjo protestë do të mënjanojë çdo përpjekje për përzierjen e kauzës studentore me politikën", theksojnë studentët.

PROTESTA E DJESHME

"Studentët kjo është koha jonë. T'u tregojmë pushtetarëve. Studentët e bashkuar kanë për ta fituar. Kërkojmë të drejtat tona. Përmirësim të kushteve të konvikteve. Ulni tarifën. Do dalim në rrugë me qindra me mijëra, po nuk ra tarifa do bie ministria. Daullet e orëve të fundit", kanë thirrur në kor studentët, ndërsa më pas disa prej tyre gjuajtën me vezë dhe shishe me ujë në drejtim të godinës së ministrisë. Studentët i kanë bërë thirrje edhe prindërve, pedagogëve dhe gjimnazistëve që të bashkohen në protestë. Para se të mbërrinin tek Ministria e Arsimit, studentët nisën marshimin nga kryqëzimi i '21 Dhjetorit', dhe u ndalën tek 'Zogu i Zi', ku u ulën në gjunjë. Me ta u solidarizuan edhe qytetarë të thjeshtë, ndërsa më pas vijuan ecjen përgjatë Rrugës së Durrësit. "Eja mblihduni këtu, këtu", "Ulni tarifën", "Shqipëria është e jona", "Jo politike këto janë disa nga thirrjet që të rinjtë lëshojnë në kor. Studentët i kërkuar presidentit të Republikës të mos dekretojë buxhetin e arsimit me këto kushte, sepse, sic thonë ata një nga kërkesat e tyre është edhe rritja e buxhetit për fushën e arsimit. "Ajo që ne pamë, është një përpjekje për t'i manipuluar studentët. Nëse tregojmë se jemi të vendosur për të gjithë kërkesat tona do të plotësohen, por, nëse nuk plotësohen, ajo do të përshkallëzohet. Deri të martën do të vendosim se nëse do të kemi përshkallëzim. Një pikë na u plotësua dhe kërkojmë edhe tre pika e tjera. Kërkojmë që presidenti të mos dekretojë buxhetin për 2019 në këtë pjesë, rritjen e buxhetit me 20%. Jemi të informuar me deklaratën e kryeministrit, ajo është e dyfytyrshme, sepse ai përzuri një nga studentët dhe e quajti ngelëse dhe e largoi me forcë nga salla. Ai po e ndjen se rinia e sotme është e fortë. Ne nuk jemi për negociata dhe grupe pune, sepse manipulohen. Negociata nuk ka. Ne jemi të vendosur në kërkesat tona. Duke qenë se ne nuk kemi një administrator të dalleshëm, ne nuk mund të kemi as grup pune. Nuk ka përçarje mes studentëve. Nesër nisim sërish lëvizjet. Protesta do të bëhet para Ministrisë. Studentët janë një dhe një për të gjithë. Ne jemi të vendosur për të plotësuar kërkesat tona dhe ne do të vijojmë protestat për të plotësuar kërkesat",- thanë studentët.

it me këto kushte, sepse, sic thonë ata një nga kërkesat e tyre është edhe rritja e buxhetit për fushën e arsimit. "Ajo që ne pamë, është një përpjekje për t'i manipuluar studentët. Nëse tregojmë se jemi të vendosur për të gjithë kërkesat tona do të plotësohen, por, nëse nuk

plotësohen, ajo do të përshkallëzohet. Deri të martën do të vendosim se nëse do të kemi përshkallëzim. Një pikë na u plotësua dhe kërkojmë edhe tre pika e tjera. Kërkojmë që presidenti të mos dekretojë buxhetin për 2019 në këtë pjesë, rritjen e buxhetit me 20%. Jemi të informuar me deklaratën e kryeministrit, ajo është e dyfytyrshme, sepse ai përzuri një nga studentët dhe e quajti ngelëse dhe e largoi me forcë nga salla. Ai po e ndjen se rinia e sotme është e fortë. Ne nuk jemi për negociata dhe grupe pune, sepse manipulohen. Negociata nuk ka. Ne jemi të vendosur në kërkesat tona. Duke qenë se ne nuk kemi një administrator të dalleshëm, ne nuk mund të kemi as grup pune. Nuk ka përçarje mes studentëve. Nesër nisim sërish lëvizjet. Protesta do të bëhet para Ministrisë. Studentët janë një dhe një për të gjithë. Ne jemi të vendosur për të plotësuar kërkesat tona dhe ne do të vijojmë protestat për të plotësuar kërkesat",- thanë studentët.

plotësohen, ajo do të përshkallëzohet. Deri të martën do të vendosim se nëse do të kemi përshkallëzim. Një pikë na u plotësua dhe kërkojmë edhe tre pika e tjera. Kërkojmë që presidenti të mos dekretojë buxhetin për 2019 në këtë pjesë, rritjen e buxhetit me 20%. Jemi të informuar me deklaratën e kryeministrit, ajo është e dyfytyrshme, sepse ai përzuri një nga studentët dhe e quajti ngelëse dhe e largoi me forcë nga salla. Ai po e ndjen se rinia e sotme është e fortë. Ne nuk jemi për negociata dhe grupe pune, sepse manipulohen. Negociata nuk ka. Ne jemi të vendosur në kërkesat tona. Duke qenë se ne nuk kemi një administrator të dalleshëm, ne nuk mund të kemi as grup pune. Nuk ka përçarje mes studentëve. Nesër nisim sërish lëvizjet. Protesta do të bëhet para Ministrisë. Studentët janë një dhe një për të gjithë. Ne jemi të vendosur për të plotësuar kërkesat tona dhe ne do të vijojmë protestat për të plotësuar kërkesat",- thanë studentët.



"PROPAGANDË MAKABRE"

"A mundet që taksapaguesve shqiptarë t'u shpëlahet turi fare, meqë duhet të jenë kundër çdo kërkesë të studentëve të universiteteve publike, të cilët po përbuzen horizontalisht dhe vertikalisht, sipas një propagande të shfrenuar dhe gati makabre sa që lockamana e madhe mund të quhet çdo ëndërr rinore. Temat për arsimin dhe të drejtat e studentëve janë të shumta dhe jashtëzakonisht fleksible. Këtu historia gënjështër që po thuret për arsimimin e të rinjve shqiptarë mbaron. Por vetëm për sot"-shkruan Natasha Lako.

"Grupe pune të posaçme, karta e studentit brenda 2019-ës"

Nikolla letër studentëve: Ja si do të zgjidhim problematikat tuaja



ligjore të cilat do të jenë, gjithashtu, pjesë e diskutimeve, të grupeve të posaçme të punës që do të ngrihen",- shkruan Nikolla në letrën drejtuar studentëve. Ajo më tej shton se studentët do të

pajisen me kartën e studentit brenda vitit akademik 2018-2019. "Lidhur me Pikën 4 dhe 5 të kërkesës, sqarojmë se mbështetja studentore për kërkimin shkencor dhe të studentëve të ciklit të



Protesta e djeshme e studentëve

KËRKESAT E STUDENTËVE

1. Përgjysmim i tarifës së studimit
 2. Rritja nga 10% në 50% e peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur kandidatët për dekan/ rektor dhe rritja e përfaqësimit të studentëve në senatin akademik me 20%.
 3. Mbështetur në nenin 99 mbi Këshillat Studentore, Ligji i Arsimit të Lartë pika 2 kërkojmë që Bordi i Administrimit të IAL-ve të ketë numër të barabartë votash si nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe IAL-të dhe të shtohet një përfaqësues në këtë bord nga studentët.
 4. Mbështetje e studentëve për kërkime shkencore.
 5. Mbështetje e studentëve të doktoraturës me fonde për kërkim shkencor.
 6. Përmirësim i kushteve të konvikteve të universiteteve.
 7. Dyfishim i buxhetit për arsimin e lartë.
 8. Pajisja e të gjithë studentëve me kartën e studentit brenda vitit akademik 2018-2019.
- *Kërkesa drejtohet nga Këshilla studentor.

"Bashkohemi me studentët"

Intelektualët duhet të bashkohen dhe t'i vijmë në ndihmë studentëve dhe japin drejtim shqetësimeve që ata ngrenë. Rinia sot po shpreh revoltën ndaj 28 viteve krim dhe korrupsion në arsim! Reforma në arsim kërkon akademik të përgatitur që e njohin arsimin e lartë dhe universitetin dhe kanë mundësinë dhe aftësinë të ndërtojnë universitetin e të ardhmes që ofron dhe prodhon dije cilësore, investon në punë kërkimore dhe përgatit specialistë në çdo fushë! Shqipëria ka tashmë nevojë më shumë se kurrë për intelektualin!",- thekson Taulant Muka.


lartë të tretë të studimeve përfshirë edhe gradën shkencore 'Doktor' tashmë është e garantuar ligjërisht. Lidhur me pikën 8 të kërkesës, sqarojmë se tashmë nga ana e MASR janë marrë masat e nevojshme dhe brenda vitit akademik 2018-2019, të gjithë studentët do të jenë të pajisur me kartën e studentit. Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sportit është e hapur dhe e gatshme për të diskutuar në institucione, sipas çdo formati të propozuar nga ju të gjitha çështjet e ngritura",- thekson ministria.



Edhe universitetet publike të rretheve, përkatësisht në Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Durrës, kanë protestuar për plotësimin e një sërë kërkesash. Ata kanë bojkotuar mësimin e kanë marshuar me pankartat ndër duar për një arsimin ndryshe. "Me ken shkodoran tana i ban, edhe tarifata i hedh n'kazan", është një nga mesazhet që studentët shkodoranë i drejtajn Ministrisë së Arsimit, ndërsa parashtrajnë disa kërkesa. Ata përveç reduktimit të tarifës së studimit, kërkojnë edhe uljen e mesatares për mbrojtjen e diplomës. Pavarësisht shfuqizimit të VKM për tarifën e provimeve të mbartura, studentët nuk tërhojnë nga protestat e tyre deri në plotësimin e të gjitha kërkesave të tyre. Pro-

"Me ken shkodoran tana i ban, edhe tarifata i hedh n'kazan"

Studentët e Shkodrës, Elbasanit, Korçës, Vlorës e Durrësit i bashkohen protestës



HEQJA E MESATARES

Pedagogu Prendi sugjeroi që të hiqet mesatarja 7 për regjistrimet e reja, sepse rrezikojnë të mbyllen degët e ndryshme si dhe kërkesat e tyre t'i marrim vetëm me shkrim. Sipas tij nuk është e vërtetë se tarifata janë vendosur nga universitetet, siç pretendon ministria.

testës së studenteve të Shkodrës i është bashkuar edhe pedagogu i letërsisë Arben Prendi. Ai i kërkon studentëve që të mos tërhojnë

nga kërkesat e tyre e madje të shtojnë kërkesat. Pedagogu Prendi sugjeroi që të hiqet mesatarja 7 për regjistrimet e reja, sepse rrezikojnë

të mbyllen degët e ndryshme si dhe kërkesat e tyre t'i marrim vetëm me shkrim. Sipas tij nuk është e vërtetë se tarifata janë vendosur nga universitetet, siç pretendon ministria.

KËRKESAT

Kërkesat e studenteve drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë janë përgjysmim i tarifës së studimit; përmirësim i kushteve të konvikteve si dhe Bordi i Administrimit të ketë numër të barabartë votash mes fakulteteve dhe Ministrisë së Arsimit, duke shtuar një përfaqësues nga studentet në bord.

Edi Rama: Detyra ime si kryetar qeverie është të dëgjoj e mbështes shqetësimet tuaja

Kryeministri fton studentët: Bujrum në zyrën time

"Dua t'ju dëgjoj ballë për ballë, pa censurë, pa praninë e askujt"

Voltiza Duro

Ditën e djeshme, kryeministri Edi Rama i ka ftuar studentët e universiteteve publike që t'i takojë e të flasë nga afër mbi problematikat që i shqetësojnë. Kreu i qeverisë tha se do të dëshironte të ishte student dhe jo kryeministër. "Një përshëndetje studentëve që sot janë përsëri në rrugë. Uroj që të kenë jo vetëm dëshirën për të protestuar, por edhe vullnetin për të dialoguar, sepse në rrugë dilët për të kërkuar vëmendjen e vendimmarrësve ndaj shqetësimit që ke. Ndërsa shqetësimi adresohet përmes dialogut me vendimmarrësit. Unë dua që ata ta dinë se kam shumë për t'u thënë, por patjetër kam shumë dëshirë t'i dëgjoj ballë përballë pa censurë për opinionin publik, pa drejtues, pa administratorë, pa pedagogë, pra studentët e zgjedhur prej vetë protestuesve si të duan dhe këtë të duan vetë pa asnjë filtër partiak apo administrativ. Ky vend e ka fituar prej 5 vitesh lirinë e plotë të protestës pa asnjë rrezik prej plumbave apo hakmarrjes politike. Kemi qenë s'kemi qenë dakord për një protestë a një tjetër, protesta në vetvete e ka pasur të garantuar si kurrë më parë pacenueshmërinë e statusit të qytetar-



FTESA

"Unë dua që ata ta dinë se kam shumë për t'u thënë, por patjetër kam shumë dëshirë t'i dëgjoj ballë përballë pa censurë për opinionin publik, pa drejtues, pa administratorë, pa pedagogë, pra studentët e zgjedhur prej vetë protestuesve si të duan dhe këtë të duan vetë pa asnjë filtër partiak apo administrativ".

isë së saj. Unë ndihem shumë mirë për këtë dhe them të drejtën po të mund të zgjidhja dot, sot do të doja të isha dhe njëherë studentë protestues jo kryeministër në zyrë", deklaroi kryeministri Rama. Ky i fundit më tej iu bëri thirrje edhe njëherë studentëve që të sh-

kojnë në zyrën e tij. Ai tha se detyra e tij si kryetar qeverie është që t'i dëgjojë dhe të mbështes shqetësimet e tyre. "Po si kryeministër dhe si protestues i dikurshëm kam bindjen se duke dëgjuar njëri-tjetrin dhe në këtë rast duke u bërë bashkë, për të shtyrë me forcë

Studentët refuzojnë Ramën: Jo negociata

Pasi kanë marrë ftesën e kryeministrit Rama për takim në zyrë, studentët refuzuan çdo lloj dialogimi e negociimi me kreun e qeverisë.

"Refuzojmë çdo lloj propozimi dhe negociatash pa pranuar 4 kërkesat tona. Nuk ka më kompromise. Kryeministri të vijë këtu se jemi të gjithë bashkë. Nuk ka negociata pa plotësuar 4 kërkesat tona"- thanë studentët. Ndërsa përmes një tjetër pankarte ata kanë ironizuar deklaratat e kryeministrit Rama, për investime në konviktet e fakulteteve. "Mbrëmë fjeta ne konviktin 3D të inxhinierisë" thuhet në një prej pankartave që studentët i mbajnë në duar. "Çdo njeri është fajtor për të mirat që s'ka bërë" thuhet në një tjetër pankartë. Në prag të festave të fundvitit, përmes një tjetër pankarte studentët kanë kryeministrit të bëhet 'Babagjysh' e të plotësojë kërkesat e tyre. "Dje bëra mirë plotësove një dëshirë, nuk e dimë sot sa dëshira do plotësohet, bëhu t'i babagjysh këtë vit, shfuqizo ligjet dhe studentët mos i mërzi!", thuhet në një prej pankartave.



SALI BERISHA: STUDENTËT PO MARRIN KËRCËNIME NGA MERCENARËT

Ish-kryeministri Sali Berisha ka reaguar në lidhje me protestën e studentëve, ndërsa sulmon qeverinë. Në një postim në Facebook Berisha shkruan se studentëve po u bëhet presion. Deputeti demokrat ka postuar një mesazh të një studentit të universitetit Aleksandër Moisiu, i cili shkruan se kanë marrë kërcënime nga Rektorati. "Pseudo intelektualë, zyrtarë, mercenarë kërcënojnë dhe ju bëjnë presion studentëve! Studentët denoncojnë pseudo intelektualë, zyrtarë, mercenarë në Universitetet e Elbasanit, Durrësit, Shkodrës dhe Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë që ju bëjnë presion dhe i kërcënojnë. Studentët denoncojnë mediat se po censurojnë protestën e tyre e fakti një revolucion i vërtet demokratik kundër Kakistokracisë!



përpara modernizimin, mund të përshpejtojmë dhe bëjmë më mirë punë kolosale. Shkurt fjala se sa rrinë në rrugë dhe çfarë kërkojnë ata, kjo është e drejta e tyre legjitime. Ama detyra ime është që t'i dëgjoj dhe t'i mbështes në adresimin e shqetësimit e tyre në çdo rast që ata do të

donin të bisedonin. Kur të duan dhe po të dëshirojnë të dinë ndonjë gjë, bujrum, kjo zyrë është e imja. Por pushteti i kësaj zyre është i kujtdo që kërkon ta përdorë për idenë e duhur në shërbim të vendit dhe shoqërisë dhe të ardhmës që fëmijët e Shqipërisë meritojnë", tha Rama.

PROJEKTLIGJI KONTROLLI

Këshilli i Legjislacionit rrëzoi me 12 vota kundër nismën e demokratëve

Nuk ka veting për politikanët, PS rrëzon nismën e PD-së

Seancës plenare do t'i shkojë raporti me dy qëndrime

Politikanët ndryshe nga gjyqtarët dhe policët nuk do t'i nënshtrohen kontrollit të intërsishëm apo siç njihet ndryshe vetingut. Kjo, pasi mazhoranca, pa pritur vendimin përfundimtar të Komisionit të Venecias, ka rrëzuar nismën e Partisë Demokratike për të sanksionuar me ligj detyrimin që edhe politikanët t'i nënshtrohen vetingut. Vendimi është marrë dje në mbledhjen e Këshillit për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku të pranishëm kanë qenë edhe përfaqësuesit e opozitës. Me 8 vota "pro" të deputetëve të djathtë dhe 12 vota "kundër" të deputetëve të mazhorancës, Këshilli hodhi poshtë projektligjin e paraqitur nga PD, ndërsa vendosi që seancën plenare t'i shkojë për miratimin një raport me dy opinione, atë me qëndrimin e mazhorancës dhe atë me qëndrimin e opozitës. Relatori i opozitës, Oerd Bylykbashi dhe raportja e shumicës parlamentare, Vasilika Hysi i paraqitën këshillit qëndrimet respektive. Kështu, Bylykbashi në emër të opozitës kërkoi miratimin e këtyre propozimeve, duke theksuar se ekziston mundësia që pas ndryshimeve në Kushtetutë, vërejtjet që bën Komisioni i Venecias mund të reflektohen në miratimin e një ligji të posaçëm për vetingun në politikë. "Mund të bëjmë përmirësime ligjore nëse nisma shqyrtohet nen për nen, të miratojmë ndryshimet kushtetuese e më pas të bëjmë ligjin e posaçëm për vetingun në politikë", tha Bylykbashi. Ndërsa, zëvendëskryetaria e Kuvendit të Shqipërisë, Vasilika Hysi theksoi se Komisioni i Venecias ka gjetur probleme në draftin e propozuar nga opozita. "Komisioni i Venecias na ka dhënë leksion se vetingut i gjyqtarëve nuk është i njëjtë me atë në politikë. Të mos e miratojmë nismën e PD dhe LSI në seancën plenare".



DEKLARATAT
HYSI
Zëvendëskryetaria e Kuvendit theksoi se Komisioni i Venecias ka gjetur probleme në draftin e propozuar nga opozita. "Komisioni i Venecias na ka dhënë leksion se vetingut i gjyqtarëve nuk është i njëjtë me atë në politikë. Të mos e miratojmë nismën e PD dhe LSI në seancën plenare".



"VENECIA"
Komisioni e konsideron të drejtë qëllimin e nismës së opozitës për të bërë vetingun në politikë për shkak të situatës aktuale në Shqipëri, por nuk mbështet mekanizmin ligjor që ajo ka zgjedhur për ta arritur këtë gjë. Ekspertët vlerësojnë se propozimi nuk ka qartësi ligjore dhe nuk ofron siguri juridike.



KRIMI
"Duket qartë se ekziston vërtet një problem i kontakteve të papërshtatshme midis politikaneve dhe elemente kriminale". Çështja e kontakteve të ngushta të anëtarëve të parlamentit, këshillit bashkiak ose zyrtarët qeveritarë, me krimin e organizuar, janë një problem në Shqipëri".

nisma u hodh në votim, duke rrëzuar me shumicë votash kundër. Sipas Rregullores së Kuvendit, raporti i shumicës parlamentare dhe mendimi

i pakicës parlamentare për këtë projektligj do t'i paraqiten për shqyrtim seancës plenare. Ndërkohë që vendimi final pritet ta mbajë se-

anca plenare, e cila pritet ta marrë në shqyrtim brenda dhjetorit. Natyrisht që ky vendim i mazhorancës pritet të acarojë edhe më tej krizën

politike në vend, pasi opozita miratimin e këtij projektligji e ka përcaktuar si kusht për t'u kthyer në sallën e parlamentit.



VETINGU
Mazhoranca ka rrëzuar pa pritur vendimin përfundimtar të Komisionit të Venecias, nismën e Partisë Demokratike për të sanksionuar me ligj detyrimin që edhe politikanët t'i nënshtrohen vetingut. Vendimi është marrë dje në mbledhjen e Këshillit për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku të pranishëm kanë qenë edhe përfaqësuesit e opozitës.

Spaho: Opozita do jetë në sallën e Kuvendit për votuar vetingun

Votimi i projektligjin për vetingun në parlament do jetë një mundësi e mirë që opozita të mund të kthehet në parlament dhe për t'u dhënë "jetë" mandatëve të deputetëve të saj. Kjo pasi kur nisma e tyre për vetingun e politikanëve të shkojë në parlament, demokratët konfirmojnë se do jenë aty, duke shmanjur në këtë mënyrë edhe djegjen e mandateve. Këtë e ka bërë të ditur kryetari i grupit parlamentar demokrat, Edmond Spaho, gjatë një reagimi për "Top Channel", i cili theksoi se opozita do jetë në parlament për të votuar vetingun dhe jo thjesht për të konfirmuar mandatet e deputetëve të saj. "Ne do të jemi në Parlament, pasi është iniciativa jonë dhe do duhet të bisedojmë për modalitetet e implementimit. S'jemi të shqetësuar për mandatet tona, por të miratohet vetingut i politikanëve, që të mos ketë më politikanë që flenë me krimin, as në




institucione qendrore, as në pushtetin vendor", tha Edmond Spaho. Por nëse nisma rrëzohet nga mazhoranca, numri dy i Partisë Demokratike të të kuptohet se opozita do të vijojë të bojkotojë parlamentin, duke paralajmëruar radikalizim të qëndrimit. "Nëse vullneti ekziston për ta miratuar, duhet t'i kthehemi normalitetit, nëse do e rrëzojë, do të vendosim për hapat e tjerë të cilët do të jenë më radikalë", tha më tej Spaho. Ndërkohë, që disa ditë më parë edhe kryetaria e LSI-së,

Monika Kryemadhi deklaroi se nuk të lejonte që të digjeshin mandatet dhe se opozita do të respektonte përcaktimet ligjore në këtë rast. Sipas Kushtetutës, mandati i deputetit humbet kur ai nuk paraqitet në Kuvend për më shumë se 6 muaj. Ndërkohë që opozita herën e fundit kur ka qenë në Kuvend ka qenë pikërisht 19 korriku, çka do të thotë që brenda 19 janarit ajo duhet të jetë në parlament. Në të kundërt rrezikon të djeg mandatet.



Këshilli i Rregullores gjatë mbledhjes së djeshme



Basha:
Vetingu, kusht për t'u kthyer në parlament

Rrëzimi i nismës ligjore për vetingun e politikanëve do të thellojë edhe më tej krizën politike në vend. Kjo, pasi opozita e këtij projektligji si kusht për t'u kthyer në Kuvend. Duke folur disa ditë më parë, gjatë një takimi partiak, kryetari i PD-së, Lulzim Basha bëri të qartë se për miratimin e vetingut nuk do të kishte asnjë lloj kompromisi me mazhorancën. "Nuk bëhet asnjë kompromis pastrim i politikanëve nga kuvendi që janë të lidhur me krimin. Kthimi në Kuvend me politikanët e lidhur me krimin, nuk ka dhe nuk do të ketë. Zgjidhja është para jush. Nuk do të ketë më trajtim preferencial për politikanët", tha Basha. Ai theksoi gjatë atij fjalimi se votimi i kësaj nisme do të ishte e vetmja zgjidhje institucionale që do të rikthente opozitën në parlament. "Nëse duan zgjidhje institucionale, është miratimi i vetingut dhe shpërrja e politikanëve mafioz nga Kuvendi dhe bashkitë", tha Basha.



Demokratët akuzuan mazhorancën se me këtë akt po synon të kapë drejtësinë

Kuvendi hedh shortin për anëtarët e KED, PD: Proces i jashtëligjshëm

Goglat përcaktuan 8 anëtarët e rinj

Kuvendi ka zgjedhur dje 8 anëtarët e rinj të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Ashtu siç edhe pritej, Kuvendi hodhi shortin pas refuzimit të Presidentit Ilir Meta për të mos e ushtruar këtë të drejtë për shkak të vakumit ligjor. Shorti ka nxjerrë 8 fitues, duke lënë një vend vakant nga Prokuroria e Apelit, pasi kishte kandidatë vetëm për një vend vakant. Në përfundim të hedhjes së shortit, kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi, shpalli emrat e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të përzgjedhur nga shorti. Kështu, Vitore Tusha dhe Bashkim Dedja u zgjodhën si përfaqësues të vetëm të Gjykatës Kushtetuese, Ardian Dvorani si përfaqësues i Gjykatës së Lartë, Arta Marku si përfaqësues e Prokurorisë së Përgjithshme, Atri Islamaj dhe Margarita Buhali si përfaqësues të Gjykatës së Apelit, Fatjona Memçaj si përfaqësuese e prokurorisë pranë gjykatave të apelit dhe Eriol Roshi nga gjykatat administrative. Ndërkohë që shorti përcaktoi edhe 3 anëtarë zëvendësues për në KED dhe përkatësisht emrat e anëtarë zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Medi Bicic, Gurali Brahimllari dhe Klodiana Veizi. Por opozita e kundërshtoi hedhjen e shortit, duke theksuar se ai zhvillohet në vakum ligjor, ndërsa theksoi se qëllimi i tij është kapja e sistemit të drejtësisë. Gjatë fjalës së tij, deputeti i PD, Oerd Bylykbashi tha se hedhja e shortit bëhet në kundërshtim me Kushtetutën e ligjin, pasi mungon baza ligjore. "Presidenti thotë se ka vakum ligjor dhe dispozitat tranzitore kanë mbyllur efektin e tyre. Kandidatët filtrohen nga 3 organe kushtetuese, Gjykata Kushtetuese, KLGJ e KLP, të cilat nuk janë ngritur ende. Qëllimi është kapja e sistemit të drejtësisë nga mazhoranca. Tërhiquni nga ky short sot dhe plotësoni vakumin ligjor për funksionimin e KLGJ e KLP", tha Bylykbashi. Ndërkohë që kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi tha se procedura për hedhjen e këtij shorti ishte konsultuar edhe me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare. "Letërn e



ANËTARËT E KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI:

1. Vitore Tusha
2. Bashkim Dedja
3. Ardian Dvorani
4. Arta Marku
5. Fatri Islamaj
6. Margarita Buhali
7. Fatjona Memçaj
8. Eriol Roshi

ANËTARË ZËVENDËSUES

1. Medi Bicic
2. Gurali Brahimllari
3. Klodiana Veizi (Mema)

BYLYKBASHI

"Presidenti thotë se ka vakum ligjor dhe dispozitat tranzitore kanë mbyllur efektin e tyre. Kandidatët filtrohen nga 3 organe kushtetuese, Gjykata Kushtetuese, KLGJ e KLP, të cilat nuk janë ngritur ende. Qëllimi është kapja e sistemit të drejtësisë nga mazhoranca".

Meta: Të punojmë çdo ditë për të fuqizuar PAK

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti dje një përfaqësi të Personave me Afësi të Kufizuara. Pasi u njoh me problematikat me të cilat kjo shtresë përballet në përditshmëri, por edhe me disa raste suksesi në rrafshin profesional, ai vlerësoi Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Afësi të Kufizuara (FSHDPAK), që merret prej viti 1996, me promovimin e mundësive të barabarta dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre në Shqipëri. "Vetëm para disa ditësh, ne kujtuam Ditën Ndërkombëtare të Personave me Afësi të Kufizuara, që na shërben si një moment reflektimi, por edhe nxitje të përpjekjeve të përbashkëta për të rritur ndërgjegjësimin për situatën në të cilën ndodhen PAK në çdo aspekt të jetës: politik, shoqëror, ekonomik e kulturor. Këtë ndërgjegjësim ne duhet ta bëjmë çdo ditë dhe jo vetëm në ditë të caktuara. Duhet të punojmë çdo ditë për të fuqizuar PAK dhe për të siguruar barazinë dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri", - tha Presidenti i Republikës.

Kryesimi i OSBE, Bushati: Fitore për politikën e jashtme

Shqipëria është votuar dje për të qenë pjesë trojkës drejtuese të OSBE, si hapi i parë drejt marrjes së presidencës së kësaj organizate në vitin 2020. Vendi ynë ka marrë mbështetjen unanime të vendeve anëtare të OSBE-së për kandidaturën e saj për të drejtuar këtë organizatë të rëndësishme në vitin 2020. Vendimi u zyrtarizua gjatë takimit të 25-të të Këshillit Ministror të OSBE-së në Milano. Lajmi është bërë i ditur nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme Ditmir Bushati. Bushati tha se angazhimet e Shqipërisë do të fillojnë kryesisht në Ballkan, duke ushtruar përgjegjësi si vend pjesëtar i Trojkës. "Ky është një vendim i madh për Shqipërinë, është një fitore për politikën tonë të jashtme, për kursin tonë konstruktiv në Ballkanin Perëndimor, në Mesdhe", shkroi ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati, në rrjetet sociale.

"Tani, hapin tjetër madhor drejt drejtësisë së vërtetë"

BE dhe SHBA përhëndesin krijimin e KED: Tani zgjidhni KLGJ dhe KLP

Bashkimi Europian ka përhëndetur zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Njëpër një postimi në rrjetet sociale, kreu i përfaqësues të BE-së në vendin tonë, Luigi Soreca shprehet se zgjedhja e anëtarëve të KED është një hap i rëndësishëm për reformën në drejtësi. Ambasadori i ri i Bashkimit Europian thekson faktin se po pret me padurim që javën e ardhshme të nisë procesi për ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, institucione këto, të cilat do i japin garanci zbatimit të Reformës në Drejtësi. "Sot, Kuvendi ka zgjedhur anëtarët e KED. Ky është një hap i rëndësishëm për zbatimin e reformës në



drejtësi. Ne presim me padurim javën e ardhshme, kur Asambleja e Përgjithshme e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve do të takohet për të ngritur KLP dhe KLGJ", thuhet në reagim. Po gjatë mbërmjes së djeshme ka reaguuar edhe ambasada amerikane, e cila nëpërmjet një statusi po në

rrjetet sociale ka kërkuar që tani të bëhet zgjedhja e KLGJ dhe KLP. "Këtë vit, Ambasada e SHBA iu ka bërë thirrje gjyqtarëve dhe prokurorëve të ndershëm, patriotë dhe me integritet për t'i shërbyer vendit të tyre në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Me formimin e këtyre dy institucioneve të drejtësisë në horizont, Shqipëria është në prag të krijimit të një sistemi drejtësie, që u shërben vërtet interesave të qytetarëve të saj. Javën e ardhshme presim me kënaqësi përzgjedhjen e anëtarëve, të cilët kanë kaluar tashmë vettingun, duke shënuar kështu hapin tjetër madhor drejt drejtësisë së vërtetë", thuhet në reagimin e ambasadës së SHBA-ve.

NOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 2/69-2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ILMI SULA.

ÇMIMI 5.445.148, 8 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 12.12.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

presidentit për shortin e kam konsultuar me ekspertët ligjore të kuvendit, EURALIUS, OPDAT. Sot është rendi që hidhet shorti. Për shortin e KED, Gjykata Kushtetuese ka sjellë dy kandidatatura. Për këtë mund të hidhen shorti pasi janë vetëm dy kandidatë për dy poste dhe dy kandidaturat vlerësohen automatikisht të zgjedhur. Bëhet fjalë për Bashkim Dedja dhe Vitore Tusha", tha Ruçi. Ndërkohë që më parë të drejtën për hedhjen e këtij shorti i kishte Presidenti i Republikës, Ilir Meta. Ai nuk pranoi ta ushtrojë këtë të drejtë me argumentin se ka vakum ligjor. "Për shkak të vakumit ligjor nuk e hedh dot shortin e KED. Ndërhyni në ligj ose në të kundërt hidhni vetë shortin sipas precedentit të vjetshëm", - thuhet ndër të tjerash në shkresën e presidentit, drejtuar Kuvendit.

Operacioni i koduar "FLEX", sekuestrohet drogë, pranga dhe armë të ftohta

Trafik kokaine me çantë "Guçi", përfundojnë në pranga 4 persona

TIRANË

Katër persona kanë përfunduar në pranga e policisë së Tiranës, ndërsa është sekuestruar 1 kg kokainë brenda një çante "Guçi". Mësohet se Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në bashkëpunim me Seksionin e Forcës së Posaçme të Operacioneve Speciale dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kuadër të operacionit policor të koduar "FLEX", arrestuan në flagrancë shtetasit: Julian Zela, 36 vjeç; Sajmir Hoxha, 44 vjeç; Besnik Mansaku, 43 vjeç dhe Rezart Hoxholli, 36 vjeç, të gjithë banues në Tiranë. Sipas bluve, për këta persona disponohej informacion se në bashkëpunim me njëri-tjetrin merreshin me aktivitetin e kundërligjshëm të shitjes së lëndës narkotike të llojit "kokainë". "Këta shtetas janë konstatuar nga shërbimet e policisë në rrugën "Janko Theodhosi" dhe gjatë kontrollit të ushtruar, shtetasit J.Z., i është gjetur brenda një çante dore një qese me lëndë të dyshuar narkotike të llojit "kokainë". Gjithashtu, janë ushtruar kontrolle në banesat e këtyre shtetasve ku janë sekuestruar një palë pranga dhe një mjet prerës", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq, po të njëjtat burime bënë me dije se gjatë operacionit në fjalë është sekuestruar në total (nga kontrolli fizik dhe kontrolli i ushtruar në banesat e shtetasve të mësipërm): 1 kg lëndë narkotike e dyshuar e



Një nga të arrestuarit gjatë operacionit të koduar "FLEX"



Kokaina e sekuestruar

llojit "kokainë"; mjet prerës (thikë), 4 aparate celular dhe pranga. Materialet në ngarkim të katër shtetasve të arrestuar iu referuan për hetime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Ti-

ranë për veprat penale: "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike e kryer në bashkëpunim", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Mbjajtja pa të drejtë e uniformës".

PERSONAT E ARRESTUAR

1. JULIAN ZELA, 36 vjeç, banues në Tiranë
2. SAJMIR HOXHA, 44 vjeç, banues në Tiranë
3. BESNIK MANSAKU, 43 vjeç, banues në Tiranë
4. REZART HOXHOLLI, 36 vjeç, banues në Tiranë

SURVEJMI

Sipas burimeve nga policia e Tiranës, katër personat e arrestuar merreshin me aktivitetin e kundërligjshëm të shitjes së lëndës narkotike të llojit "kokainë" dhe mbareshin në survejim nga efektivet e sektorit të Antidrogës. Ata akuzohen për veprat penale: "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike e kryer në bashkëpunim", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Mbjajtja pa të drejtë e uniformës".



U sekuestruhen mina me telekomandë, arrestohen dy persona nga Kukësi

KRUJË - Policia e Durrësit dhe ajo e Krujës kanë finalizuar operacionin e koduar "Muzgu" duke goditur një grup që trafikonte lëndë plasëse dhe radioaktive. Në operacion janë sekuestruar mina me telekomandë, ndërsa janë vënë në pranga dy persona. Specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme dhe Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, në bashkëpunim dhe me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, mbremjen e së enjtes kanë arrestuar në flagrancë për veprën penale "Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive" e kryer në bashkëpunim, shtetasit: A.B, 38 vjeç dhe H.Gj, 26 vjeç, të banues në Kukës. Mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative nga ana e Strukturave policore se shtetasit e mësipërm trafikonin lëndë plasëse, në momentin e arrestimit të tyre në Thumanë, brenda një çante në ngjyrë të zezë u janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provave materiale tre kallëpe cilindrike të mbështjellë me letër kartpeçetë dhe natriban transparent, ku ishin të vendosura tre kapsolla detonatore të lidhura me tel përcjellës të kapura me natriban, ku në anën tjetër ishin të bashkuara me dy aparate celularë të markës "Nokia". Kallëpet ishin me peshë rreth 225, 240 dhe 469 gr secili. Sipas informacioneve këto mina me telekomandim, mund të përdoren në kryerjen e veprave të rënda kriminale. Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë për veprime të mëtejshme.



Me armë zjarri në brez, bie në pranga 37-vjeçari

LUSHNJE - Një 37-vjeçar është arrestuar nga policia e Lushnjës, pasi ishte shpallur në kërkim. Në pranga ka përfunduar B.L., banues në Lushnje sepse ka kanosur me pistoletë shtetasin E.Xh., 38 vjeç në tetor të këtij viti. Sipas bluve, shtetas B.L. ishte shpallur në kërkim për veprën penale: "Kanosje" dhe "Armëmbajtje pa leje", pasi në datën 19.10.2018, pranë lokalit të shtetasit me iniciale S.Ç., në lagjen "Gafurr Muço" Lushnje, ka kanosur me armë zjarri pistoletë shtetasin E.Xh., 38 vjeç. Gjatë kontrollit të trupit që ju bë shtetasit B.L., iu gjetën një armë zjarri pistoletë tip "TT" me 7 fışkë. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për veprat penale "Kanosja" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak".

Ekzekutuan 2 kushërinjtë për drogën, dënohen 5 shqiptarët në Itali

ITALI - 16 deri në 20 vite burg ka dhënë gjykata e Buso Arsizio në Milano për 5 shqiptarë, të akuzuar për vrasjen e kushërinjtë të tyre Agron dhe Alban Lleshaj. Bëhet fjalë për një ngjarje të ndodhur gjatë natës mes 9 dhe 10 nëntorit të vitit 2016 në periferi të Milanos. Viktimat u ekzekutuan me pistoletë poshtë një kompleksi banimi, pas një ndjekjeje me makinë. Dënimi për Edmond, Elidon, Pjetër Lleshaj (ky u fundit me të njëjtin mbiemër, por pa lidhje familjare me viktimat), Eduard Nikolli dhe Fatjon Stojan u dha nga gjykatësja Pjera Bossi. Prokurori Giuseppe D'Amico kishte kërkuar burgim të përjetshëm për të pandehurit. Sipas hetuesve, banda i ekzekutoi dy kushërinjtë pasi këta të fundit po tentonin që të zgjeronin aktivitetin e trafikut të kokainë në Legnano. Menjëherë pas ekzekutimit autorët u arratisën nga frika e gjakmarrjes nga familjarët e dy viktimave. Për këtë arsye, përpara se të arrestoheshin nga oficerët e Monzas, banda e trafikantëve kishte lëvizur nëpër qytetet të ndryshme, në qendër dhe veri të Italisë, ndërsa një prej tyre kishte arritur që të dilte nga Italia. Ata u arrestuan mes Pistoia, Luça dhe Belgjikës. Nga hetimet rezultoi, gjithashtu, se 5 të dënuarit drejtëshin nga një tjetër shqiptar, i njohur me nofën "Kuqi". Ata vendosën që t'i ekzekutojnë dy kushërinjtë Lleshaj, së bashku me një kushëri të tretë, i cili arriti të shpëronte, në mënyrë që të mos i lejonin që të kontrollonin shpërndarjen e kokainës mes Canegrate, Legnano dhe Parabiago. /tvklan.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 14,760,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 28 Dhjetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Nëna e 31-vjeçares: Vajza mund të humbte jetën, në Bulqizë s'ka mjek gjinekolog

Enver Doçi

BULQIZË

Një 31-vjeçare nga një fshat i thellë i Bulqizës dhe që ishte në muajin e pestë të shtatzënisë pasditen e djeshme ka humbur trinjakët e saj. Bëhet fjalë për Enkeleda Rexhepin, që udhëtoi për një orë në kalë e më pas me makinë nga Ostreni për në spitalin e Bulqizës, ku nuk ka mjek gjinekolog. Ajo ka lindur para kohe fëmijën e parë me asistencën e mjekëve dhe infermierëve të këtij spitali, por ka hasur vështirësi për dy të tjerët. Nisur nga situata tejet emergjente, drejtuesit e spitalit të Bulqizës kanë kërkuar ndihmë nga materniteti "Mbretëresha Geraldinë" në Tiranë. 35 minuta pas njoftimit dhe ndihmës së kërkuar, një ekip mjekësor nga kryeqyteti ka shkuar me helikopter nga Tirana në Bulqizë. Falë asistencës mjekësore të mjekëve specialistë nga Tirana si dhe stafi mjekësor të spitalit të Bulqizës, 31-vjeçares është shpëtuar jeta. Ndërkaq, mësohet se gjendja e 31-vjeçares është e stabilizuar dhe ndodhet jashtë rreziqut për jetën. Sipas dëshmitave të para, gruaja ka thënë se ka qenë duke kryer punë bujqësie të rënda deri kur i kanë nisur dhimbjet dhe është nisur për në spital. Pas humbjes së trinjakëve, nëna e Enkeleda Rexhepit u shpreh për "Gazeta Shqiptare", se stafi mjekësor i spitalit të Bulqizës dhe ekipi që mbërriti nga Tirana bënë të pamundurën dhe i shpëtuan jetën vajzës së saj. Ndërsa, tha se i vjen shumë keq për trinjakët dhe se është e trishtueshme që Bulqiza nuk ka mjek gjinekolog. Ndërkaq, drejtori i spitalit të Bulqizës, Hazis Jella deklaroi se në institucionin që ai drejton ka staf mjekësor, sallë operacioni dhe sallë lindjeje. Sipas tij, gruaja shtatzënë humbi trinjakët për shkak të një aborti.

Udhëtoi 1 orë me kalë nga fshati, gruaja 5 muajshe shtatzënë humb trinjakët në spital

Drejtori i spitalit, Hazis Jella: Ishte abort, fetuset ishin në papajtueshmëri me jetën



31-vjeçarja Enkelejd Rexhepi



Drejtori i spitalit, Hazis Jella, duke folur për "GSH"

NDIHMIA

Nisur nga situata tejet emergjente, drejtuesit e spitalit të Bulqizës kanë kërkuar ndihmë nga materniteti "Mbretëresha Geraldinë" në Tiranë. 35 minuta pas njoftimit dhe ndihmës së kërkuar, një ekip mjekësor nga kryeqyteti ka shkuar me helikopter nga Tirana në Bulqizë. Falë asistencës mjekësore të mjekëve specialistë nga Tirana si dhe stafi mjekësor të spitalit të Bulqizës, 31-vjeçares i është shpëtuar jeta.



Nëna e 31-vjeçares, Zenepe Grana, duke folur për "GSH"

APELI

Nëna e Enkeleda Rexhepit, Zenepe Grana dje falënderoi stafin mjekësor të spitalit të Bulqizës, që i shpëtuan jetën vajzës së saj. "Rëndësi ka që më ka shpëtuar vajza, por keq më erdhi dhe për trinjakët që ishin të moshës 5 muajshe për 6-të. Mjekët dhe mamitë e spitalit bënë gjithçka, bënë të pamundurën që të më shpëtonin time bijë", tha Grana. Ndërkaq, ajo u shpreh se mungesa e mjekut gjinekolog në Bulqizë mund t'i kushtonte jetën vajzës së saj. "Është e domosdoshme që në Bulqizë të ketë mjek gjinekolog. Nëse nuk do të kishin ardhur mjekët nga Tirana, vajza ime mund të rrezikonte jetën", pohoi Grana.

tëresha Geraldinë" nga Tirana, i cili ka bërë ndërhyrjen për dy fetuset e tjera. Gjatë gjithë kohës, gruas i është dhënë ndihmë si nga stafi ynë dhe nga ekipi mjekësor i ardhur me helikopter nga Tirana. Me koordinimin e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, që bëri të mundur këtë koordinim në kohë reale dhe për rrjedhojë i është shpëtuar jeta gruas 31-vjeçare. Dua të theksoj se ishte abort dhe fetuset kishin një peshë 300-400 gramë të papaj-

tueshme për jetën", shtoi drejtori i spitalit të Bulqizës. **DËSHMIA E NËNËS SË 31-VJEÇARES**
Nëna e Enkeleda Rexhepit, Zenepe Grana dje falënderoi stafin mjekësor të spitalit të Bulqizës që i shpëtuan jetën vajzës së saj. "Rëndësi ka që më ka shpëtuar vajza. Por keq më erdhi edhe për trinjakët që ishin të moshës 5 muajshe për 6-të. Mjekët dhe mamitë e spitalit bënë gjithçka, bënë të pamundurën që të më shpëtonin time bijë. Unë e

"Për 20 minuta helikopteri mbërriti në Bulqizë"

Reagon Ministria e Shëndetësisë: Ekipi i mjekëve nga Tirana shpëtoi nënën e re

TIRANË - Ministria e Shëndetësisë ka reaguar pas ngjarjes së rëndë në Bulqizë, ku një grua e re ka kryer abort për shkak të komplikacioneve. Sipas MSH, për shkak të moshës së vogël të barrës (24 javë është) e papajtueshme me jetën, trinjakët nuk kanë mundur të mbijetojnë, ndërsa nëna tashmë është jashtë rreziqut për jetën dhe në këto momente është nën kujdesin e mjekëve. "Lidhur me ngjarjen e ndodhur në spitalin e Bulqizës, sqarim opinionin publik si më poshtë: Nëna me inicialet E.R. 31 vjeç është paraqitur në spitalin e Bulqizës në orën 12:00 të ditës së sotme. Nëna e re është asistuar për lindjen



e trinjakëve me moshë barre të parakohshme, 24 javëshë. 31-vjeçarja është asistuar për lindjen e fëmijës së parë nga mjeku i përgjithshëm Fatos Hoxha dhe dy mami të maternitetit të Bulqizës. Për shkak të komplikacioneve, menjëherë është njoftuar ekipi i urgjencës kombëtare mjekësore dhe është nisur nga Ti-

rana një ekip i specializuar nga Materniteti "Mbretëresha Geraldinë" me helikopterin e Urgjencës Kombëtare. Brenda 20 minutash, helikopteri me ekipin e specializuar nga Tirana ka mbërritur në spitalin e Bulqizës. Ekipi i specializuar të maternitetit të Tiranës kanë asistuar dy lindjet e tjera dhe kanë shpëtuar nënën e re, e cila rrezikonte jetën. Për shkak të moshës së vogël të barrës (24 javë është) e papajtueshme me jetën, trinjakët nuk kanë mundur të mbijetojnë, ndërsa nëna tashmë është jashtë rreziqut për jetën dhe në këto momente është nën kujdesin e mjekëve", ka deklaruar Ministria e Shëndetësisë.

kam takuar vajzën dy ditë radhazi, erdha e takova dhe nuk kishte asnjë lloj dhimbjeje. Edhe sot (dje) ajo nuk kishte dhimbje deri në orën 10. Më pas nuk ka mundur të ngrihet. Vajza ka tentuar të komunikonte me mjekët e Tiranës, pasi para një muaji ka qenë për vizitë

në Tiranë, por nuk i kanë hapur telefonin. Më pas ajo është lidhur me spitalin e Bulqizës dhe ka ardhur në këtë spital, por këtu nuk ka mjek gjinekolog. E përsëris, stafi mjekësor bëri të pamundurën. Ata ishin më në siklet se unë që e kisha fëmijë. Është e domosdoshme që

në Bulqizë të ketë mjek gjinekolog. Nëse nuk do të kishin ardhur mjekët nga Tirana, vajza ime mund të rrezikonte jetën", tha e ëma e Enkeledës. Ndërkaq, edhe vetë kjo e fundi ka falënderuar stafin e spitalit të Bulqizës dhe ekipin nga Tirana që i shpëtuan jetën.

STRATI Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shlyerjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Apartment Nr. 37", me sipërfaqe 69.7 m², i ndodhur në katën e pestë, seksioni i dytë të godinës 8 katëshe, në Linzë, Komunë Dajç, Tiranë, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor me Nr. 2099, datë 09.07.2007, Zona Kadastrale 2460, regjistruar në pronësi të EuroVini sh.p.k. Çmimi fillestar i ankandit është 19,516 Euro.
Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datën 10.12.2018.

Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e dytë, për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme, për të cilat ka vene hipoteke NBB BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:

Lloji njesi me sip. 189 m² me pasurië 5/188/nd-1, z.k.8350 vol 28 fq146 RRP.Muzeqari TIRANË në pronësi të z.Ajvan Rahmi BAHOLLU
Çmimi me të cilin fillon shlyerja në ankand është 179.760 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë) EUR
Lloji apartamenti sip.132m² z.k.8350 nr.pas.5/188/nd-1-19 vol 28 fq.185 Rruga Prokop Myzeqari TIRANË në pronësi të z.Ajvan Rahmi BAHOLLU
Çmimi me të cilin fillon shlyerja në ankand është 73.920 (shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzetë) EUR
Ankandit zhvillohet në datën 08.01.2019, në porandim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbarimit gjyqësor me adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web: www.studijustitia.com, tel. +355 4 2270890

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e dytë, për shlyerjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vene hipoteke NBB BANK/ABI BANK, me këto të dhëna:

Lloji i pasurisë Ares-Trulli (magazine dykate) me sip. arë 3000 m² /rruall 166/1 ndërtesë 234.3, me nr.pasurie 589 vol 8 fq.76, z.k.1475, Derven, KRULË në pronësi të Haki Ahmet MAVRICI
Çmimi me të cilin fillon shlyerja në ankand është 67.200 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) EUR

Ankandit zhvillohet në datën 09.01.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbarimit gjyqësor, me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web: www.studijustitia.com, tel. +355 4 2270890

Hapat që duhet të ndiqni për të marrë vulën apostile

Legalizimi i dokumenteve në ambasadë, ja ndryshimet

Selia diplomatike italiane: Dhe kosto më e ulët

Ndryshon procedura e legalizimit të përkthimeve. Nga 1 janari 2019 nuk do të jetë më e nevojshme që dokumentet të paraqiten në ambasadën italiane. Selia diplomatike njofton se për t'u ofruar një shërbim më të mirë shtetase në aspektin ekonomik dhe në lidhje me lehtësimin e procedurave, duke filluar nga data 1 janar 2019, do të vendoset vula apostile edhe për përkthimet e njohura (sikurse parashikohet në nenin 1 të Konventës së Hagës së datës 05.10.1961, në fuqi mes Italisë dhe Shqipërisë prej datës 01.07.2011). Për të qenë të vlefshme në Itali, dokumentet e lëshuara nga autoritetet shqiptare në Shqipëri duhet të jenë të pajisura me vulë apostile të dyfishtë, të vendosur nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë mbi dokumentin origjinal në gjuhën shqipe dhe mbi përkthimin në gjuhën italiane. Pra, nuk do të jetë e nevojshme që të kërkohet legalizimi i përkthimit pranë autoriteteve konsullore italiane në Shqipëri. Procedura e re që duhet ndjekur për të legalizuar përkthimin e njohur

me vulë apostilë për dokumentet shqiptare që do të dorëzohen në Itali do të jetë si më poshtë:

1. Përkthimi do të kryhet nga një përkthyes i njohur, firma e të cilit është depozituar pranë Ministrisë së Drejtësisë. Përkthyesi do të vendosë në përkthim këtë diciturë: "Deklarohet se ky përkthim është i njëjtë me tekstin origjinal në gjuhën shqipe dhe se është kryer nga 'Emri dhe Mbiemri', përkthyes i njohur i akredituar pranë Ministrisë së Drejtësisë shqiptare". Do të vendoset firma dhe vula e përkthyesit të njohur.

2. Në bazë të nenit 65 të Ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, një noter shqiptar do të deklarojë vërtetësinë e nënshkrimit dhe statusin ligjor të përkthyesit të njohur.



Ambasada Italiane në Tiranë

thyesit të njohur.

3. Mbi dokumentin dhe përkthimin do të vendoset vula "Apostile" nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Dokumenti origjinal i pajisur me apostile dhe i shoqëruar

nga përkthimi po ashtu i pajisur me apostile mund të paraqitet pranë autoriteteve italiane në Itali. Procedura e re do të ketë kosto më të ulët se shifra 3030 lekë që kushton aktualisht, ndërsa koha e mar-

rjes së shërbimit do të jetë më e shkurtër. Ambasada italiane thekson se shtetasi shqiptarë kanë gjithsesi mundësi që të kryejnë përkthimin zyrtar të dokumenteve nga përkthyes të njohur në Itali.

PERKTHIMI

Përkthimi do të kryhet nga një përkthyes i njohur, firma e të cilit është depozituar pranë Ministrisë së Drejtësisë. Përkthyesi do të vendosë në përkthim këtë diciturë: "Deklarohet se ky përkthim është i njëjtë me tekstin origjinal në gjuhën shqipe dhe se është kryer nga 'Emri dhe Mbiemri', përkthyes i njohur i akredituar pranë Ministrisë së Drejtësisë shqiptare".



REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA KUSHTETUESE KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit":

1. Rishpall 2 (dy) vende vakante për "Specialist IT" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË PARË PËR "SPECIALIST IT":

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë eksperiencë në menaxhimin e projekteve TIK.
- Të ketë eksperiencë në hartimin e politikave të brendshme IT dhe planifikime në fushën IT.
- Të ketë njohuri shumë të mira për infrastrukturën e IT dhe sistemet të cilat implementohen mbi to.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT TË DYTË PËR "SPECIALIST IT":

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

2. Shpall 1 (një) vend vakant për "Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.

KËRKESA TË POSAÇME TË POZICIONIT "PËRKTHYES":

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht- Shqip;
- Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

KUSHTET TË PËRGJITHSHME PËR VENDET VAKANTE "SPECIALIST IT" DHE "PËRKTHYES"

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për të pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për të përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 dhjetor deri më 12 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 12 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 dhjetor deri më 12 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të notuarizuar. Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.



Diskutim mbi funksionimin e Gjykatës Supreme në Shtetet e Bashkuara

"Luarasi" pret pedagogen e njohur amerikane në leksionin e hapur


McLauchlan: Uroj që studentët të kenë reflektuar

Voltiza Duro

Universiteti "Luarasi" vijon traditën e lek sioneve të hapura me ekspertët më të mirë. Ditën e djeshme, studentët e Fakultetit të Drejtësisë në këtë institucion elitare, patën mundësinë e artë të ndjekin leksionin e profesores së shquar të së drejtës kushtetuese, Judithanne McLauchlan, e cila është lektore në Universitetin e Floridës së Jugut. Ajo u shpërgoi studentëve funksionimin e Gjykatës Supreme amerikane, e cila funksionon edhe si Gjykatë Kushtetuese. E themeluar në vitin 1790, gjykata supreme cilësohet si instanca më e lartë juridike në vend. Proceset gjyqësore kryesohen nga juria e shtetit, ku është kryer krimi dhe përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga presidenti, emërimi i tyre është i përjetshëm dhe kanë trajtim të barabartë me ministrat.

LEKSIONI

Pedagogia thotë se përsosja e sistemit të drejtësisë në vendin e saj nuk ka qenë aspak një rrugë e lehtë, por sot gjithkush e di që në çdo gjykatë amerikane, gjyqtari do ta trajtojë me drejtësi çështjen. Dhe kjo është e rëndësishme për demokracinë. "Ishte vërtet kënaqësi të isha këtu, në universitetin "Luarasi" për të zhvilluar një leksion para studentëve të drejtësisë. U fol për Gjykatën Supreme amerikane dhe për proceset gjyqësore që zhvillohen atje, si dhe për shtetin e së drejtës dhe implementimin e legjislacionit në Shtetet e Bashkuara. Me studentët diskutuam, shprej që t'i kem frymëzuar sadopak që dhe ata të japin maksimumin kur nesër të dalin nga bankat e shkollës dhe të kontribuojnë në fushën e drejtësisë. Ju e dimi që ne e kemi zhvilluar sistemin tonë të drejtësisë për qindra vjet. Është shumë e rëndësishme që njerëzit në një demokraci të ndihen të sigurt në lidhje me institucionet e drejtësisë", - tha Judithanne McLauchlan. Profesoria e njohur, e cila ka punuar në



Judithanne McLauchlan, lektore në Universitetin e Floridës së Jugut dhe në universitetin "Luarasi"



JUDITHANNE MCLAUHLAN

"Unë shprej se studentët kanë reflektuar, duke mësuar më shumë për sistemin tonë të drejtësisë dhe shtetin e së drejtës, shprej që ata do të reflektojnë për sistemin në Shqipëri", - tha pedagogia e së drejtës kushtetuese.



Gjykatën Supreme, por edhe në administratën "Klinton" shprej gjithashtu që studentët të reflektojnë. "Unë

shprej se studentët kanë reflektuar, duke mësuar më shumë për sistemin tonë të drejtësisë dhe shtetin e së

drejtës, shprej që ata do të reflektojnë për sistemin në Shqipëri", - tha pedagogia e së drejtës kushtetuese.

TRADITA

Dy ditë më parë, universiteti "Luarasi" priti në auditorin e tij, avokaten e njohur shqiptare, aktualisht studiuese dhe pedagoge pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Oksfordit, Rudina Jasini. Kjo e fundit është një ndër emrat më të njohur për sa u përket shumë çështjeve penale të së drejtës ndërkombëtare. Ekspertja e fushës së drejtësisë zgjodhi pikërisht universitetin "Luarasi" për të dhënë leksionin e saj të parë në vendin e origjinës. Jasini ka qenë pjesë e grupit të avokatëve në mbrojtje të kryeministrit Ramush Haradinaj në gjykatën ndërkombëtare në Hagë. Studentët e jurisprudencës në universitetin "Luarasi" shumë shpejt do të jenë avokatë, gjyqtarë dhe prokurorë. Pedagogia shqiptare e Oksfordit iu sugjeron atyre të mos reshtin duke kërkuar të drejtat e veta. "Ishte një kënaqësi shumë e madhe për mua të mbaja leksionin e parë në Shqipëri apo para studentëve. Kam pasur mundësinë të mbaj ligjëratat të tjera edhe në vende të ndryshme të botës. Besoj se kurioziteti, interesi apo dhe dëshira e motivimi që këta studentë kanë për të avancuar në fushën e djes, ishte ajo që mua më ka bërë më shumë përshtypje në universitetin "Luarasi", - thotë Jasini.

Klosi: Importi i makinave të vjetra, i nevojshëm

Ndotja e mjedisit, ndjekje penale për dhunuesit e natyrës

Kush ndot mjedisin, do të ndiqet penalisht. Kjo është ajo çka është diskutuar gjatë mbledhjes së përfaqësuesve të disa prej institucioneve më të rëndësishme në vend, që mbulojnë çështjet mjedisore. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi tha se

janë identifikuar 18 industritë përgjegjëse për nivelet më të larta të ndotjes në vend dhe se nuk do të ketë asnjë tolerim ndaj tyre. Ai u ndal edhe të vendimi për ndalimin e hyrjes në Shqipëri të mjeteve me moshë të madhe, duke e quajtur të datueshëm, por të nevojshëm. Kreu i Komisionit Parlamentar të Veprim-

tare Prodhuese, Eduard Shalsi përmendi tri shtyllat ku duhet të përqendrohet veprimi kundër krimit mjedisor: Ndërhyrjet në Kodin Penal, reformimi i institucioneve si dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore. Ambasadori i OSBE-së, Bernd Borchardt në fjalën e tij theksoi nivelin shumë të ulët të hetimeve e dënimeve për



Krimet mjedisore, nga prerja e pyjeve, te depozitimi ilegal i mbetjeve, deri te dëmtimi i shtretërve të lumenjve.

Ja kush e zuri vendin e gruas së hekurt në partinë konservatore gjermane

Ikën pas 18 vjetësh nga CDU-ja Angela Merkel

Kancelarja: Ka ardhur koha "për një kapitull të ri". Rrini të bashkuar

Delegatët e partisë kristiandemokrate, CDU janë mbledhur në Hamburg, ku do të zgjidhet sot pasardhësja/pasardhësi i kryetares së partisë, Angela Merkel, e cila do të vazhdojë të mbetet kancelare. Kryetarja e deritanishme e partisë kristiandemokrate CDU, Angela Merkel, u largua nga ky post pas 18 vitesh, me një fjalim, i cili u përcoll me brohoritje dhe duartrokitje frenetike. "Ka qenë një nder i madh, një kënaqësi e madhe". Me këto fjalë Merkel përfundoi fjalimin 35-minutësh, për herë të fundit si kryetare e CDU-së. Merkel bëri një rishikim të kohës në krye të partisë, duke theksuar sukseset, por edhe dështimet në faza të ndryshme. Kancelarja tha se tani ka ardhur koha "për një kapitull të ri" dhe ftoi partinë e saj që të mbetet e bashkuar. Ndërja, me lot dhe duartrokitje. Pas fjalimit, ajo u përshëndet me një duartrokitje të gjatë prej gati 10 minutash. 1001 delegatët e mbledhur në Hamburg u ngritën nga vendi, shumë prej tyre mbanin pankarta me mbishkrimin "Paleminderit shefe!". Nuk mungonin as lotët e shumë delegatëve, ndërsa Merkel gjatë fjalimit ishte shumë personale dhe e prekur nga duartrokitjet e gjata, të cilat ndërprisnin shpesh fjalimin e saj. 64-vjeçarja Angela Merkel largohet nga posti i kryetares së partisë CDU pas plot 18 vitesh. Por, ajo vazhdon të mbetet kancelare e Gjermanisë. Më fjalë të mira për udhëheqjen e kancelares në periudhën e kaluar folën të gjithë ata që morën fjalën para saj, por edhe pas saj. Ndonëse edhe



Angela Merkel

vetë Merkel e kishte të qartë se gjatë kësaj kohe ka pasur edhe ngjarje aspak të lehta. "Se ku na çojnë grindjet mes vete, këtë më së miri e kanë kuptuar CDU dhe CSU vitet e fundit", tha Merkel, e cila bëri thirrje që këto parti të vazhdojnë të bashkëpunojnë ngushtë mes tyre.

PASARDHËSJA

Delegatët e kongresit dje pasdite zgjodhën pasardhësen e Angela Merkelit, e cila është Annegret Kramp-Karrebauer. Kramp-Karrebauer, e njohur si AKK, mundi rivalin e saj kryesor, avokatin Friedrich Merz, një kritik të vendosur të Merkelit, fi-



Annegret Kramp-Karrebauer

KANDIDATET

Për postin e kreut të CDU kandiduan sekretarja e përgjithshme e CDU, Annegret Kramp-Karrebauer, ish-shefi i grupit parlamentar në Bundestag, Friedrich Merz dhe ministri i Shëndetësisë, Jens Spahn

torja e të cilit të do përfaqësointe një ndërprerjeje vendimtare nga trashëgimia dhe politikat e kancelares aktuale. AKK, një ndjekëse vensnike e kancelares aktu-

FJALIMI

Kryetarja e deritanishme e partisë kristiandemokrate CDU, Angela Merkel, u largua nga ky post pas 18 vitesh, me një fjalim, i cili u përcoll me brohoritje dhe duartrokitje frenetike. "Ka qenë një nder i madh, një kënaqësi e madhe". Me këto fjalë Merkel përfundoi fjalimin 35-minutësh, për herë të fundit si kryetare e CDU-së.

ale, pritet të përballet me një betejë të madhe si udhëheqëse e CDU. Partia kohët e fundit ka përjetuar një rënie të konsiderueshme të mbështetjes, duke tërhequr afro 30% të votimeve, krahasuar me 40% që kishte në kulmin e Merkel. Për postin e kreut të CDU kandiduan sekretarja e përgjithshme e CDU, Annegret Kramp-Karrebauer, ish-shefi i grupit parlamentar në Bundestag, Friedrich Merz dhe ministri i Shëndetësisë, Jens Spahn. "DW"

Adriatik Stavileci: Pagesat e deritanishme, minimale

Taksa 100% ndaj Serbisë, sa ka rënë importi që nga 6 nëntori

Dikur vlera e importit nga Serbia vetëm brenda një dite ka qenë 1.2 milionë euro, ndërsa që prej 6 nëntorit, kur është marrë vendimi nga Qeveria e Kosovës për rritjen e taksës 100 për qind ndaj mallrave me origjinë nga Serbia, importi është vetëm 140 mijë euro. Që prej marrjes së vendimit për rritjen e tarifës, efekti i saj është se ka rënë vlera e importit prej 20 milionë euro. Nga këto masa, zyrtarë të Drogës së Kosovës

IMPORTET

"Pas aplikimit të masës së dytë prej 100 për qind më 21 nëntor, ne kemi vërejtur stagnim total të importit nga Serbia. Nëse dikur brenda një dite janë importuar nga Serbia rreth 1.2 milionë euro produkte, tani kjo ka rënë në disa qindra euro.

thonë se vlera e importit nga Serbia është mjaft e ulët. Zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, thotë për "KosovaPress" se 2 deri 3 mijë euro kanë qenë rreth 48 dërgesa për import të lëndës së parë. "Krahasoni mes dy periudhave, në mes të nëntorit 2017 dhe të vitit 2018, ku qeveria ka ndër-

marrë masat mbrojtëse tregon që rënia e vlerës së importit prej Serbisë është 20 milionë euro deri në këtë moment", ka thënë Stavileci. Ai ka treguar se importi nga Serbia ka rënë vetëm pas masës 100 për qind. Zëdhënësi i Doganës ka treguar se më datën 6 nëntor ka filluar aplikimi i



Adriatik Stavileci

masës mbrojtëse prej 10 për qind, e cila ka qenë rreth dy javë dhe në javën e parë me 10 për qind taksë, ka pasur një vazhdimësi të importit të rregullt edhe përkundër masës prej 10 për qind, ndërsa në javën e dytë ka pasur një ulje të importit. "Pas aplikimit të masës së dytë prej 100 për qind më 21 nëntor, ne

kemi vërejtur stagnim total të importit nga Serbia. Nëse dikur brenda një dite janë importuar nga Serbia rreth 1.2 milionë euro produkte, tani kjo ka rënë në disa qindra euro. Për arsye se në këto dy javët e para të aplikimit të masës prej 100 për qind, ne kemi vërejtur që kemi pasur vetëm 140 mijë

euro importe prej Serbisë. Kjo është një vlerë shumë minimale. Të gjitha këto importe kanë qenë me vlera shumë të ulëta, 2-3 mijë euro kanë qenë rreth 48 dërgesa, të cilat kanë paguar këtë taksë, pasi ka qenë edhe lëndë e parë", tha Stavileci. Mirëpo, pas këtij vendimi për mallrat serbe, ka pasur disa produkte ushqimore të kontrabanduara. "Deri tani gjatë këtyre dy javë kemi pasur kapje të rasteve të kontrabandimit me disa produkte si me vezë, me produkte ushqimore, por sidoqoftë nuk ka qenë në nivelin shqetësues", theksoi ai. Ai ndër të tjera ka thënë se pas vendimit të ministrit të MTI-së, rreth 17 kamionë janë kthyer mbrapsht në Serbi, me produkte të cilat kanë pasur mbishkrime "Kosovo i Metohija".

BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 638

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtune 8 Dhjetor 2018

KENGA MAGJIKE




FINALJA 2018, JA KUSH "RREMBEN" KUPËN

Dua Lipa & Bebe Rexha



Shpërthejnë në lot shqiptaret!
Nominohen për çmimet "Grammy"

KENGETARJA



KJO S'PRITEJ! ADELINA TAHIRI MËSON BASHKËSHORTIN TË FLASË SHQIP

MARTOHET ÇIFTI I NJOHUR I SHOWBIZIT SHQIPTAR?



Ja detaji që na ka shpëtuar

KLAUDIA PEPA TAKOHET ME ALBI NAKON DHE ALBA HOXHËN. JA Ç'KA NDODHUR



Nga "Best New Artist" te çmimi i parë, njëzetë finalistët e edicionit të 20 të festivalit

Formalitet finalja e Kënga Magjike 2018? Ja kush "rrëmben" kupën

Prapaskenat e surprizat e natës së tretë të eventit të madh të muzikës në Pallatin e Kongreseve

Pamela Aliaj

Ky edicion i 20-të i Këngës Magjike mund të themi me plotë gojë se ishte një nga edicionet më me energji dhe me frymë të re, e cila i dha të tjera ngjyra dy netëve të para të tij. Ndërsa sonte është nata finale dhe ditën e djeshme këngëtarët kishin marrë gjithë kohën e tyre për të votuar kolegët, do të presim 'në ethe' deri në momentin e fundit për të parë kush do ta rrëmbejë kupën. Apo jo? Me aq sa kemi parë këto 20 edicione të zhvilluara ndër vite disa gjëra, pavarësisht rive, nuk ndryshojnë kështu që mund të themi se me hamendësime e me disa përllogaritje të thjeshta logjike, kush mund të jetë kryesuesi i çmimit të parë për këtë 20-vjetor. Përpara se të kalojmë në atë që ne mendojmë se do të jetë fituesi (mbase edhe ju jeni aq të sigurtë sa ne), do të ndalemi pak tek organizimi e surprizat e këtij evenimenti. Ndërsa dy netët e para ishin të mbushura plot emocion me praninë e balerines Klaudia Pepa, e cila edhe performoi në një kërcim tepër elektrizues natën e parë, të papriturat s'përfundonin me kaq! Mbrëmjen e të enjtes nata nisi nga shtëpia e missit të parë shqiptar Valbona Selimllari ku së bashku me të ishin të mbledhura aktorja Elia Zaharia Zogu, aktorja Olta Gixhari dhe blogerja Armina Mevlani. Të gjitha këto bukurishe kanë prezantuar ndër vite në një nga edicionet e këtij festivali. Vajzat donin të ishin sërish pjesë e festivalit edhe këtë vit e për këtë ar-



sye Gjebrea vendosi se do të bashkëprezantojë në natën finale së bashku me moderatorët Bora Zemani dhe Klaudia Pepa. Mbetet për të parë se si do të vijë nata finale e këtij edicioni të 20-të. Pra, një nga sekretet e natës së sotme është se imazhit të Këngës Magjike,

Ardit Gjebrea do t'i bashkohen të gjitha prezantueset ndër vite. Një emocion i veçantë pritet të përcillet këtë mbrëmje! Ndërkaq do të ndalemi pak edhe tek konkurrentët. Duke qenë se nata finale, pa llogaritur netët live kur performuan, jep tepër emocion, të nxit të tregosh

edhe frikërat apo ethet e konkurrimit. Një gjë e tillë ka ndodhur me këngëtarën Ronela Hajati. Pak përpara natës finale së edicionit të 20-të të "Kënga Magjike" këngëtarja Ronela Hajati ka falënderuar të gjithë personat që e kanë mbështetur në rrugëtimin e saj të gjatë në

muzikë. "Jam rritur në skenë dhe synimi im i vetëm ka qenë të bëj publikun për vetë. Kurrë nuk kam konkurruar diku me qëllimin të fitoj çuditërisht...Unë ju kam fituar ju. Siç e kam ndjerë çdo herë. Kjo është e pakrahueshme me çdo lloj kupe. Ju dua me zemër që keni qenë e vetmja gjë ku jam kapur edhe në momentet më të vështira e atëherë kur kam dashur të heq dorë. Faleminderit përgjithmonë, Ronela", përfundon këngëtarja në rrjete sociale. Pra, me pak fjalë publiku për këngëtarin është burimi i energjisë dhe shtysës për të vijuar më tutje me karrierën e tyre. Një gjë e tillë e ka ndjerë nga afër së fundmi edhe konkurenti tjetër, Flori Mumajesi. Ai ka performuar në gjysmëfinalen e dytë të Këngës Magjike. Kënga e tij është një nga këngët favorite për të fituar këtë edicion të festivalit. Flori ka bërë me të vërtetë bujën me baladën 'Plas', ndërsa fansat mezi kanë pritur që ta shohin interpretimin e tij 'live'. E Flori nuk ka zhgënjyer! Flori u duartrokoi nga një numër i madh i njerëzve ku prej fillimit cilësohet si favorit për të fituar edicionin e 20-të, të festivalit "Kënga Magjike".



Por s'ishte i vetmi Flori për të cilin u ngrit publiku në këmbë. Edhe interpretimi live i këngës së Fifi dhe MC Kreshës me hitin 'Psikopatja jote' në gjysmëfinalen e dytë të Këngës Magjike i ka elektrizuar të gjithë. Dëshja edhe një herë kanë dëshmuar se ata kanë këngën e preferuar të publikut në këtë edicion të festivalit. Në momentin kur Fifi ka filluar performancën, gjysma e publikut në Pallatin e Kongreseve janë ngritur në këmbë dhe kanë kënduar bashkë me Fifi gjithë tekstin e këngës. Por disa konkurrentë të tjerë edhe s'pretendojnë asnjë gjë veçse ta festojnë këtë edicion të 20-të të këngës magjike. Të gjithë mendojnë se nëse është Aurela, sepse sa herë është në garë ajo, nuk ka më sfidë, pa dyshim ajo është fituese, dhe e ka vërtetuar! Por këtë vit, ajo që është kthyer në klishe 'Aurela fiton Këngën Magjike', me sa duket, nuk duket e tillë për vetë Aurelën. Këtë vit, së bashku me Eli Farën, dy mikeshat kanë sjellë një këngë feste, "Zemra rratatata" dhe kështu duan ta kalojnë këtë edicion. Në një prononcim për një media rozë, pas pyetjes "A do ta fitojë edhe këtë vit Këngën Magjike?", Aurela përgjigjet: "Jo, e dashur. edhe dy herët e fundit kur jam future (se herën e parë këngën "Hape veten" e kisha me qëllimin jo të fitoja, por të dilja fort dhe kënga u ndërtua në atë mënyrë. Dy këngët e tjera unë i këndova për qejfin tim, paçka se edhe ato i bëra fort. Sivjet, ne jemi futur për të festuar. Po ta dëgjoni dhe këngën, kënga është qejf, me vargje të thjeshta, të kuptueshme, shqip, pastër. Është e qëllimshme, mos kujtoni se ne e bëjmë pa qëllim, por ishte dëshira e të djavje, edhe eELIT, edhe e imja, dhe ia kemi kërkuar Adi Hilës me ngulm që kënga të kishte ndjesi feste, sepse njerëzit janë kaq të lodhur... Këtë herë vendosëm të vinim si festë dhe erdhëm për t'i thënë publikut 'faleminderit që na keni dashur gjithë këto vite. Po deshtë, na duar-trokisni prapë...' - tha Aurela. A do vetëm të shijojë festën apo të rrëmbejë çmimin, do ta shohim natën e sotme,



edhe pse nuk na duket se Aurela ka ardhur për garë këtë vit, por për qejf, si gjithë herët e tjera! Por pas përfundimit të dy netëve gjysmëfinale, ku artistë 'Big' e të rinj performuan live në Pallatin e Kongreseve të kualifikuarit për në finalen e së shtunës me siguri janë sot nën ethet e garës për çmimin e madh. Të gjithë e dimë se Kënga Magjike në çdo edicion të saj ka nxjerrë hite e këngë që i kanë rezistuar kohës, ky edicion është vërtetë shumë më i veçantë se gjithë edicionet e tjerë. Këtë vit janë 26 artistë të rinj që kanë kaluar në fazat gjysmëfinale e ky numër i madh nuk është aspak rastësisht, por duket se artistët BIG nuk janë të vetmit pretendentë të çmimit në Këngën Magjike 2018. Kjo jo vetëm për risitë që sjellin dhe emocionet në këngët e zhanrit baladë që mbizotëron në këtë edicion, por edhe për faktin se këtë edicion të rinjtë janë prurje të "The Voice" dhe "Gjeniu i Vogël". Por s'duhet të harrojmë se nuk është vetëm vendi i parë i cili merr kupë, kështu që po të bëjmë një vlerësim nga publiku si virtual ashtu edhe live në konkurrencë të ngushtë janë këngët e Florit "Plas" dhe duetit Fifi ft MC Kresha "Psikopatja jote". Ndërkaq pas tyre vjen kënga e Ronela Hajatit "Vuj" dhe dueti i Ardit Çunit me Daniela Toçin "Qaj". Më poshtë po ju japim një renditje të vlerësimit të tanishëm të konkurrentëve dhe renditjen.

Në youtube:
1. Fifi me MC Kreshën - "Psikopatja jote" e me 4.8 milionë klikime dhe 12 mijë pëlqime
2. Stresi - "Të du mom" me 2.8 milionë klikime dhe 27 mijë pëlqime

- 3. Ronela Hajati - "Vuj" me 2.5 milionë klikime dhe 14 mijë pëlqime**
- 4. Ardit Çuni dhe Daniela Toçi - "Qaj" me 2.4 milionë klikime dhe 19 mijë pëlqime**
- 5. Kanita - "S'jemi ne" me 2.1 milionë klikime dhe 11 mijë pëlqime**
- 6. Flori Mumajesi - "Plas" me 1.8 milionë klikime dhe 30 mijë pëlqime**
- 7. Artiola Tosta ft Bruno - "Digjem" me 1.5 milionë klikime dhe 9 mijë pëlqime**
- 8. Olsi Bylyku ft Lorenc Hasrama - "Si të flas" me 1.2 milion klikime dhe 18 mijë pëlqime**
- 9. Krusita - "Akull" me 1.1 milionë klikime dhe 9 mijë pëlqime**
- 10. Aurela Gaçe ft Eli Fara - "Zemra Rratatata" me 1 milion klikime dhe 9 mijë pëlqime**
- 11. Klajdi Haruni - "Nuk të dua dot më pak" me 1 milion klikime dhe 8 mijë pëlqime**
- 12. Kejsi Tola - "Më ke mua" me 780 mijë klikime dhe 6.6 mijë pëlqime**
- 13. Era Rusi - "Mos ma merr" me 755 mijë klikime dhe 4.2 mijë pëlqime**
- 14. Rozana Radi - "Kur përfundon një dashuri si kjo e jona" me 250 mijë klikime dhe 4.1 mijë pëlqime**
- 15. Erik Lloshi - "Mos Urre" me 222 mijë klikime dhe 2.3 mijë pëlqime**
- 16. Rovena Dilo ft Onati - "Ma jo" me 161 mijë klikime dhe 570 pëlqime**
- 17. Robert Aliaj - "Ah ku më hodhi Zoti" me 108 mijë klikime dhe 4 mijë pëlqime**
- 18. Venera Lumani - "Lind për ty" me 57 mijë klikime dhe 1 mijë pëlqime**
- 19. Mentor Haziri - "Më**

ke vra" me 39 mijë klikime dhe 404 pëlqime
20. Kastro Zizo - "Sonata e gjumit" me 12 mijë klikime dhe 220 pëlqime

Por pas kësaj renditje nuk duhet të harrojmë së përmenduri edhe faktin se kantautori Flori Mumajesi ka gisht në pothuajse gjysmën e projekteve të suksesshme muzikore me të cilat konkurrentët kanë marrë pjesë në 'Kënga magjike'. Pra, një numër i madh i tyre janë punuar nga ThreDoots dhe votat e shumta nga ta do ti takojnë pikërisht Florit. Kënga e tij 'Plas' u pëlqye jashtëzakonisht shumë nga publiku ndërsa ritheksojmë se gara është shumë e fortë. Pra, konkurrenca e fortë është mes këngës "Plas" të Flori Mumajesit dhe "Psikopatja jote" e Fifi me MC Kreshën. Nëse do të llogarisim pikët e bash-



këpunëtorëve del logjikisht që Flori rrëmben kupën, por nëse do të shohim vlerësimin e publikut do duhet të themi se Fifi meriton kupën këtë mbrëmje. Sado të sigurtë të jemi dhe të jeni e vetmja gjë e sigurtë këtë mbrëmje janë të papriturat dhe emocionet e pafund kështu që shijojeni! Le të fitojë më i miri!



Shpërthejnë në lot shqiptaret! Dua Lipa dhe Bebe Rexha nominohen për çmimet “Grammy”

Më në fund Dua Lipa dhe Bebe Rexha kanë bërë realitet ëndrrën e çdo këngëtari. Ato janë nominuar në “The Grammy Awards”, çmimet më prestigjioze të muzikës. Të dyja këngëtares me origjinë shqiptare janë nominuar në kategorinë “Best New Artist” (Artisti i Ri më i Mirë), së bashku me Chloe x Halle, Luke Combs, Greta Van Fleet, H.E.R, Margo Price dhe Jorja Smith. Çmimi “Best New Artist” i referohet çdokujt që me projekte të ndryshme ka ndikuar jashtëzakonisht në peizazhin muzikor. Përveç kësaj, Dua është nominuar edhe në kategorinë “Dance/Electronic Music” në këngën “Electricity”. Për këdo që nuk e di, Dua ishte pjesë e këngës “Electricity” të projektit “Silk City”, i cili u krijua nga DJ dhe producenti amerikan, Diplo në bashkëpunim me këngëtarin, tekstshkruesin dhe DJ britanik, Mark Ronson. “Silk City”, projekt dhe turne që përfshin këngë të albumeve “Silk City” dhe “Cowboys and Casanovas”, është ndër të tjera një formë homazhi për të gjitha qytetet e mëdha të muzikës “dance”, si Londër, Paris, Detroit, Çikago, Nju Jork etj. dhe është quajtur kështu duke iu referuar lokalit në Filadelfia, ku Diplo nisi karrierën si DJ rreth 20 vite më parë. Një ngjarje e tillë është shoqëruar me emocione të forta të këngëtares, që siç mund ta shihni në video, kanë shpërthyer në lot. Ceremonia e 61-të e “Grammy Music Awards” do të mbahet më 10 shkurt 2019, në Staples Center në Los Angeles. Çdo ditë e më shumë na bëjnë krenarë!




Gëzim në familjen e Aurela Gaçes, ia kush i “hoqi trurin” këngëtares

Dita e djeshme ka qenë e shënuar për këngëtares Aurela Gaçe. Dy vite më parë ajo ka sjellë në jetë vajzën e saj të dytë, Abigail. Me anë të një postimi në “Instagram”, Aurela i bën dedikimin më të ëmbël të shtrenjtës së saj. “Si sot dy vjet më parë, në këtë orë erdhe në jetë ti, jeta jonë, bota jonë. Përfundimisht, kjo na e hoqi trurin të gjithëve në shtëpi, neve edhe Grace, motrës së madhe apo si ka ardhur edhe goja tani, edhe tëpë tëpë tëpë gjithë ditën... Zot, faleminderit për këtë bekim!”, ka shkruar këngëtarja në krah fotos së të bijës. Vërtet e bekuar me një familje të tillë!



Stresi bën urimin emocionues për ditëlindjen e së ëmës nga burgu

Kënga e reperit Stresi, “Të du mom”, është pa diskutim një nga këngët më të pëlqyera të edicionit të 20 të “Kënga Magjike” dhe ndër më të klikuarat në “Youtube”. Për fat të keq, Stresi nuk mundi të performonte në netët gjysmëfinale, pasi ndodhet ende në burg. Ditën e djeshme nëna e reperit, ajo të cilës i është kushtuar kënga, kishte ditëlindjen. Stresi i ka dedikuar të ëmës fjalë shumë prekëse në postimin e tij të fundit në “Instagram”. “E shtrenjta ime mom, gëzuar ditëlindjen! Megjithëse nuk jam pranë teje sot fizikisht, me shpirt më ke gjithmonë pranë, ti e di që je dashuria ime më e madhe që kam!”, shkruan Stresi. Por nuk ka munguar as urimi i Keisit, bashkëshortes së Stresit, e cila edhe pse larg familjes, nuk e ka anashkaluar një urim publik për vjehrrën e saj, që e ka cilësuar si nënë. “S’ka dashuri më të madhe se nëna!”



Kjo s’pritej! Adelina Tahiri mëson bashkëshortin të flasë shqip

Çdo ditë e më tepër Adelina Tahiri është e përfshirë në rrjetet sociale me postimet e saj të njëpasnjëshme. Së fundmi ajo vendosi të postonte një video. Përveç pamjes së shtëpisë luksoze, ajo që ra në sy ishte fakti se këngëtarja po e përfshin bashkëshortin maqedonas në kulturën shqipe. Në një darkë familjare, Adelina Tahiri ka prezantuar anëtarët e familjes së saj, bashkë me djalin. Në këtë darkë nuk kishte se si të mungonte edhe bashkëshorti i këngëtares, me të cilin ajo shfaqej shumë e afërt e madje i shprehte se e donte para të gjithëve. Në një moment madje ajo i flet shqip dhe ai ia kthen gjithashtu në gjuhën shqipe, duke treguar se ai po mëson të flasë gjuhën tonë. Tashmë Adelina shihet se Jonit po i flet vetëm në shqip.

Emocionon me fjalët Jul Deda: Na zbukurove jetën!

Të gjithë gjënë më të shtrenjtë në jetë kanë pa diskutim familjen dhe dashuria vetëm atyre u përket. Këtë gjë e ka treguar edhe aktori i humorit Jul Deda, i cili ka bërë një dedikim emocionues dhe prekës për "shokun e tij" më të mirë. Djali i Julit mbush 10 vjeç dhe ai ka zgjedhur fjalët më të ndjera për të urrear të birin. "Sot është dita jote kampion. Ti Mateo nuk e mban mend se çfarë ndodhi 10 vjet më përpara, s'ka gjë e mbajmë mend unë dhe sidomos mami. Na u bë një dhuratë hyjnore. Erdhe ti. Jo vetëm kaq, por ne dimë çdo detaj, çdo gjë që ke bërë deri sot, jo sepse kemi memorie të mirë, por sepse ti je protagonist i që na pushtove mendjen dhe zemrat, duke mos lënë kala pa na marrë nga brenda. Na mbushte familjen. Na zbukurove jetën. U rrite kampion. E kuptoj çdo ditë, nga mënyra si flet, si e percepton jetën dhe si reagon, e kuptova sidomos sot, kur të dëgjova duke bërë titur nëpër shtëpi 'O baaa, ku është xheli i flokëve'. U bëfsh 100 vjeç shoku im më i mirë! Të kam jetë e frymëzim. Të dua pafund", - ka shkruar Juli.



Largohet nga "Tring", moderatori i njohur zhvendoset në "Klan" me një tjetër mision

Të gjithë jemi mësuar ta shohim në "Tring", por tani jo më. Nëpërmjet një postimi në "Instagram", moderatori i njohur Xhani Shqerra ka zbuluar "shtëpinë" e re. Pas largimit nga "Tring", moderatori ka vendosur që të zhvendoset në "Klan Plus", për të prezantuar emisionin "Bel Mondo", i cili nis transmetimin më 15 dhjetor. Ai shprehet entuziast për detyrën e re dhe premtom se do të tregojë një tjetër dimension. "Ju premtova dimensione të reja dhe e mbajta fjalën. Kjo sepse komunikimi me të gjithë ju, për të bukurën, nuk është vetëm një mision për mua, por një filozofi jete. Nëse kthej kokën pas, kujtoj me shumë respekt familjen e fisshme të 'Tring', e cila më hapi dyert e më mësoi të besoj tek idetë e pasioni im. Sot jam gati për të marrë disa përgjegjësi më të mëdha e për të vazhduar këtë mision në një familje të re, por me themele të forta, vlerat e së cilës janë një pasuri kombëtare. Për të informuar, komunikuar, kulturuar dhe zbatimur nga shqiptarët për shqiptarët, në 'Klan'. Shihemi në 'Klan Plus', Bekime", - shkruan krahas postimit Xhani Shqerra. Prej disa vitesh Xhani moderoi së bashku me Brunilda Lahen emisionin "Living", i cili transmetohej në "Tring". Suksese të mëtejshme Xhani, të shohim ç'surpriza na rezervon.

"Si e bija e dikujt që kaloi 25 vite në burgje", ja pse Jona Spahiu mbështet protestën e studentëve

Vijojnë ende protestat në vend nga një numër i madh studentësh prej disa ditësh në kryeqytet, duke shtruar një sërë kërkesash për Ministrinë e Arsimit. Protesta ka marrë përmasa të mëdha dhe i janë bashkuar edhe studentët nga rrethet. Një prej personazheve publikë që ka shprehur mbështetjen e saj për studentët është edhe Jona Spahiu. Moderatorja ka zgjedhur "Instagramin" për të bërë të ditur qëndrimin e saj. Ajo ka postuar një foto ku shfaqet një numër i madh studentësh të fotografuar nga lart. Në krah të fotos, Jona ka treguar për herë të parë se i ati ka kaluar 25 vite në burg, në kërkim të së drejtës dhe është shprehur se mbështet studentët dhe se kjo protestë është gjëja më shpresëdhënëse që ka parë. "Si një qytetare e këtij vendi, si një studente e dalë nga fakultetet monopol, si e bija e një njeriu që kaloi 25 vitet e jetës së tij në burgjet komuniste në kërkim të së drejtës... Kjo është gjëja më shpresëdhënëse që më kanë zënë sytë", - ka shkruar ajo. Protestës i janë bashkuar edhe një numër i madh personazhesh publikë si Gentian Zenelaj, Florian Binaj, Robert Aliaj, Blendi Fevziu, Roza Lati etj.



Ndodhi ajo që pritej! Klaudia Pepa takohet me Albi Nakon dhe Alba Hoxhën

Historia e Albi Nakos dhe Klaudia Pepës është pa dyshim një nga historitë e dashurisë më të përfolura në "showbiz"-in shqiptar. Edhe pse prej më shumë se një viti kanë konfirmuar ndarjen, ata kanë treguar se vazhdojnë të ruajnë marrëdhënie miqësore me njëri-tjetrin. E kthyer në Shqipëri për prezantimin e "Kënga Magjike" krah Ardit Gjebreas dhe Bora Zemanit, balerina e famshme ka rrëfyer edhe ritakimin me ish-bashkëshortin e saj. E pyetur nga "Thumb" nëse janë takuar me Albin dhe si kanë reaguar Klaudia tha: "Para ca ditësh ai ishte me grupin e baletit me Albën. Erdhën të gjithë të më takonin. Erdhi edhe Albi, edhe Alba dhe u treguan shumë të mirë e të dashur. Edhe unë gjithashtu i putha e i përqafova". Pas këtyre fjalëve të Klaudias verifikohet më bindshëm lidhja e Albës me Albin, edhe pse këta dy të fundit s'e kanë pranuar asnjëherë. Të shohim ç'detaje të tjera "prapa kuintave" do shfaqen për ta vërtetuar.

Martohet çifti i njohur i showbizit shqiptar? Ja detaji që na ka shpëtuar



Vetëm para pak muajsh zbuluam më në fund lidhjen më të re në showbizin shqiptar! Këngëtarë Skerdi dhe gazetaria kosovare Vesa Rama nuk qëndruan më në heshtje dhe zyrtarizuan lidhjen në publik pas një periudhe të gjatë që e mbajtën atë hermetike. Por duket se një tjetër zhvillim ka ndodhur së fundmi. Mesa duket çifti ka kurorëzuar dashurinë në martesë, apo celebrim. Kjo të paktën nëse i hidhet një sy profilit të Vesës në 'Instagram'. Ajo ka shtuar mbiemrin e Skerdit, Ago duke ngritur në këtë formë dilemat e kurorëzimit larg syrit të publikut. Meqenëse vetë protagonistët kanë zgjedhur të mos flasin, s'na mbetet gjë tjetër pos të presim nëse vendosin ta bëjnë publik zhvillimin e ri përmes ndonjë fotografie në rrjete sociale. Edhe kjo është një mënyrë e heshtur "deklarate" apo jo?

Festat e fundvitit erdhën në shtëpinë e Nora Istrefit! Këngëtarja shfaq pamje nga shtëpia luksoze



Nora Istrefi a ka ndarë kohën nga agjenda e saj e ngarkuar me xhirime klipesh e koncerte, për ta dekoruar shtëpinë e saj në Prishtinë. Brenda ambienteve luksoze të pronës që ajo posedon në periferi të kryeqytetit, këngëtarja ka bërë mrekulli duke organizuar një ambient tejet të ngrohtë. Me pemën e vitit të ri të dekoruar në një qosh të sallorit të saj gjigant Nora Istrefi, i ka shtuar hijeshi ambientit ku jeton me familjen e saj, ndërsa me anë të një videoje që publikoi në Instagram, ajo na e shpalosi edhe një pjesë të shtëpisë së saj që s'e kishim parë më herët.



Me mbi 1.7 miliardë herë e dëgjuar dhe e vlerësuar, Rita Ora falënderon fansat për këtë vit të pabesueshëm

Platformat e mëdha të muzikës "Spotify" dhe "Apple Music", kanë prezantuar së fundmi statistikave të tyre vjetore, për artistët më të dëgjuar brenda vitit. Pas statistikave të Dua Lipës dhe Era Istrefit, vijnë edhe ato të Rita Orës, e cila, gjithashtu, ka thyer rekorde këtë vit. Rita ndau me ndjekësit e saj në 'Instagram' disa imazhe, ku pasqyroheshin të arriturat e saj përgjatë vitit, të kalkuluara nga platforma më e madhe e muzikës në botë, "Spotify". Ora këtë vit është dëgjuar mbi 766 milionë herë nga 66 milionë fansa prej 65 shteteve të ndryshme, të cilët gjithsej kanë shpenzuar mbi 42 milionë orë në këngët e saj. Këto shifra e bënë këngëtarën shqiptare gjithashtu artisten me më së shumti këngë solo në top listën zyrtare britanike, për çka edhe hyri në histori. Në total, ajo numëron mbi 1.7 miliardë dëgjime nëse statistikave të "Spotify" iu bashkohen edhe ato të



Awards", ku shqiptarja rrimbeu çmimin "Kënga më e mirë ritmike", për këngën "Lonely together", në bashkëpunim me Avicii. Rita Ora, shqiptarja e parë që u shpërblye me një çmim në "MTV Video Music Awards". Për të gjitha këto suksese, këngëtarja shqiptare shprehet e falënderuar në një postim të gjatë të bërë në rrjetin social 'Instagram'. "Jam kaq falënderuese dhe mirënjohëse sa shumë mbështetje kam marr prej të gjithë fansave dhe e gjithë industria muzikore që më suportoi mua. Unë solla albumin tim të parë para gjashtë vitesh dhe të kesh kaq shumë mbështetje është jashtëzakonisht bukur për mua, faleminderit djema", kanë qenë fjalët e Ritës në 'Instagram'. Përmendur, viti 2018 ishte një vit shumë i rëndësishëm në karrierën e këngëtares, kjo pasi këtë ajo solli albumin e saj të dytë me titull "Phoenix", pas një pritje të gjatë gjashtë vjeçare, si pasojë e problemeve të shumta dhe proceseve gjyqësore kundrejt ish-studios së saj incizuese, "Roc Nation", të menaxhuar nga reperi me famë botërore, Jay-Z.

"Apple Music". E dëgjuar mbi pesë miliardë herë - Spotify dhe Apple Music prezantojnë rekordet e Dua Lipës këtë vit. Mbi 250 milionë herë është dëgjuar vetëm kënga e saj hit "Let you love me", të cilën këngëtarja e publikoi në shtator. Këto statistika e kanë bërë atë artisten globale më të mirë në zhanrin POP, gjersa suksesi maksimal u arrit në mbrëmjen e ndarjes së çmimeve "MTV Video Music

EKSPOZITA

Paralelet e Sigurimit të Shtetit me STAS-in gjerman

Fatmira Nikolli

Fate individësh të përzgjedhur qartësojnë se çfarë do të thoshte për njerëzit e prekur 'përpunim' nga STASI, përmes prezantimit të çështjeve specifike operative". Maren Glen Kasmi, anëtar i Autoritetit, shprehet se "nëpërmjet ekspozitës 'Mbikëqyr! Terrorizo! Përndiq!' jo vetëm hedhim dritë mbi veprimtarinë e STASI-t, por tregojmë edhe ngjashmëritë e STASI-t me Sigurimin e Shtetit".

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me "Inner Wheel Club" Tirana mundëson për gjimnazet e Tiranës ekspozitën e veprimtarisë së STASI-t në Gjermaninë Lindore, realizuar me Autoritetin Gjerman të Hapjes së Dosjeve, BSTU.

Ekspozita titullohet "Mbikëqyr! Terrorizo! Përndiq" dhe zhvillohet në kuadër të edukimit qytetar, një ndër shtyllat e veprimtarisë së institucionit. Veç prezantimit të ekspozitës për të rinjtë e shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", aktiviteti vijon me bashkëbisedimin me një të mbijetuar të përndjekjes, ish-i dënuar i burgut të Burrelit, Saimir Maloku. Materialet e ekspozitës janë organizuar në tematika, të përkthyer në shqip. Ata i informojnë të interesuarit për strategjitë e survejimit dhe përndjekjes në Gjermaninë Lindore, duke ofruar paralele të qarta me realitetin shqiptar. "Shokë, duhet të dimë gjithçka", ishte motoja që ministri i Sigurimit të Shtetit, Erih Milke u jepte punonjësve të tij. "Me këto informacione duhet të zbuloni dhe të bëni të padëmshëm 'armiqtë' e Partisë së Bashkuar Socialiste Gjermane, për të siguruar pushtetin e saj në DDR". Për të përmbytur këtë mision, Ministria e Sigurimit të Shtetit (MfS) kishte kompetenca të zgjeruara: ajo ishte në të njëjtën kohë policia e fshehtë shtetërore, hetuesi dhe shërbimi i zbulimit të jashtëm. E bazuar mbi pesë tematika: rinia, udhëtimet, kultura, kisha dhe sporti - ajo tregon se si STASI e mbikëqyrte dhe kontrollonte jetën e përditshme të popullsisë. Ai i referohet përvojës gjermane si model ballafaqimi të një shoqërie demokratike me të kaluarën diktatoriale të vendit. Autoriteti e mbështet punën e vet dhe vijmësinë e projekteve të ndërmarrura në parimet e rëndësishme të kujtesës, që e vënë memorien historike në themel të identitetit dhe trashëgi-



Ekspozita "Mbikëqyr! Terrorizo! Përndiq!" prezantohet për të rinjtë e gjimnazeve

misë së individëve e bashkësive, si paraqitja e këndvështrimeve të ndryshme; evitimi i shprehjeve deterministe: shmangia e

përgjithësimeve, trajtimi i figurave historike si individë, siguri mi i një baze gjenueine historike, përdorimi i njohurive të nivelit



akademik si burime, ku çdo përm-bajtje duhet të ballafaqohet e të diskutohet me akademikë të njohur dhe certifikuar për njohuritë specifike e të duhura për këtë punë. Mbështetur në këto parime, në kërkimin shkencor dhe përballjen profesionale të fakteve, Autoriteti

vijon të ndërmarrë projekte ambicioze e komplekse, që kanë në fokus rishqyrtimin e historisë, rivlerësimin e saj, rehabilitimin e viktimave, rezistencën në personalitete e komunitete dhe inkurajojnë dialogun social, në emër të transparencës dhe konsolidimit të demokracisë.

PËRTEJ MUREVE E IKONAVE, RUAJTJA E TRASHËGIMISË NË FSHATRA TË JUGUT

Trashëgimia kulturore ka shërbyer për të tërhequr vëmendjen drejt fshatrave të jugut, ku stili i kahershëm zbehej e zhbehej nën ndikimin e kohës. Përtej siteve arkeologjike, e nevojshme ishte edhe ruajtja e traditave të zonave që po ndjenin braktisjen, tekta ngjyrat iknin e muret dobësoheshin. Pasuria nisi të mirëmbahej, mbrohej dhe rijetësohej përmes programit "Zhvillimi i Integruar dhe i Qëndrueshëm i Rajonit Bregdetar Jugor" i financuar nga Qeveria Gjermane dhe implementuar nga GIZ, pas një sërë vizitash e konsultash në fshatrat e Himarës. Në fund të një procesi të gjatë që edhe i ka dokumentuar pasuritë e trashëgimisë në gjendjen që janë sot, është bërë edhe prezantimi i "Udhëzuesit praktik për mbrojtjen dhe ruajtjen e banesave tradicionale në fshatrat e bregdetit të Himarës". Në fokus të këtij udhëzuesi janë 14 fshatra: Palasë, Dhërmi, Ilias, Vuno, Himarë fshat, Pllur, Kudhës, Qeparo i vjetër, Borsh, Pigeras, Sasaj, Lukovë, Shën Vasil dhe Nivicë. Qëllimi i udhëzuesit përtej shpjegimit të kontekstit dhe karakterit të fshatrave, ka qenë këshillimi dhe orientimi për ata që merren me zhvillimin, rinovimin dhe rikonstruksionin e ndërtesave të fshatit. Udhëzuesi ka të njëjtën rëndësi e vlerë si për banorët, edhe për pronarët e qiramarrësit e ndërtesave sikundër për institucionet, administratorët, kompanitë ndërtuese, mjeshtrit e



ndërtimit dhe artizanët. Duke qenë se grupi i punës ka qenë i përbërë nga profesionistë të trashëgimisë, gasja e ofruar ruan të shkuarën përmes rijetësimi të saj sot. Kësaj, tekta gjen shtëpitë e dikurshme si në fotot bardhezi, merr ngjyrat e sotme 'të fshatit' jo vetëm për pushime - ai është ende vendi ku jetohej e shijohet, në shtëpitë e banueshme, të mbuluara me tjegulla, të ndërtruara me gurë, me oborret e vogla dhe lulet përfund të tyre. Udhëzuesi, identifikon elementet tipike të fshatrave dhe ndërtesave, të cilat kanë formuar karakterin e tyre lokal, me qëllim që të sigurojë që çdo ndërtim i ri të jetë në përputhje me këtë karakter. Kjo, në fakt do të mund të ruajë portretin e dikurshëm, pa e ndalur zhvillimin - çka ka munguar nëpër qytetet e mëdha të zhëbra tashmë. Udhëzuesi është vlerësuar me çmimin e nderit në kategorinë e Dizajnit Urban gjatë ceremonisë së Çmimeve të Ekse-

lencës së INTBAU 2018 (INTBAU Excellence Award) të zhvilluar në "Royal Society of Arts", në Londër më 28 nëntor, gjatë Kongresit Botëror të INTBAU 2018. Po ashtu, gjatë prezantimit të Udhëzuesit në ArtTurbina dy ditë më parë, u nda me të interesuarit një studim mbi Modelet e Qëndrueshme të Ruajtjes së Trashëgimisë dhe Rijetëzimit të Qendrave Historike, Vuno & Qeparo, përshatuar në kontekstin vendës nga CHWB (Trashëgimia Kulturore pa Kufij). Puna e ekspertëve të CHWB është mbështetur në një kërkim akademik të programit të Menaxhimit Urban në Universitetin Teknik të Berlinit, gjatë vitit akademik 2017, pas vizitës së tyre studimore në fshatrat Vuno e Qeparo. Gjatë aktivitetit u soll një përmbledhje e veprimtarisë së programit dhe institucioneve partnere, në fushën e ruajtjes së trashëgimisë si atelieri i restaurimit "Kisha Shën Serxhi & Shën Baku, në Himarë

Fshat/Qendër Historike" - Aplikacioni dixhital i Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore, në qarkun e Vlorës - Atelier Lukova, projekt i Bashkisë Himarë, AKPT mbështetur nga GIZ - Vizitat studimore në formën e seminarit me studentë të FAU, me temën "Skicimi i Trashëgimisë Kulturore dhe Arkitektonike". Në përfundim u ekspozuan disa vizatime akuarel të peizazheve arkitektonike të 5 fshatrave të bregut. Implementimi nga GIZ i programit të financuar nga Qeveria Gjermane "Zhvillimi i Integruar dhe i Qëndrueshëm i Rajonit Bregdetar Jugor" është i shtrirë në harkun kohor 4 vjeçar, mars 2015 - shkurt 2019. Qëllimi kryesor është rritja e mundësive që popullsia rurale të mund të përfitojë nga zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në rajonin e bregdetit jugor të Shqipërisë. Programi konsiston në territor dhe planifikim. Vëmendje e veçantë i kushtohet konservimit urban apo modeleve të qëndrueshme për rijetësimin e fshatrave të bregut, të cilat kanë një peizazh tipik kulturor e tradicional. Zhvillimi dhe pilotimi i modeleve të turizmit të qëndrueshëm dhe përfshirja e produkteve lokale në zinxhirin e vlerave të turizmit është po ashtu në fokus. Këta dy komponentë, të kombinuar me njëri-tjetrin sigurojnë një rezultat më të mirë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në zonën e jugut.f.a.ni.

Opinion

i Ditës

Jo arsimit të lartë publik bankomat

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... të larta. Ato duhet të rishikohen. Tarifat për provimet e mbarura janë absurde në kushtet tona dhe qeveria veprimi drejt kur bëri prapakthehu. Tani ia vlen të rishikohet vetë ligji mbi arsimin e lartë. Ai nuk përmban qoftë edhe një fjali për shërbimet studentore, edhe pse është relativisht i ri (ripunuar në vitin 2015). Universitetet publike duhet të marrin në konsideratë të gjitha çështjet në funksion të studentit. Studentët në universitetet publike duhet të ndajnë se kanë shanse të njëjta dhe të barabarta për të zhvilluar potencialin e tyre. Universitetet duhet të sigurojnë që të gjithë studentët të trajtohen në mënyrë të barabartë. Këtë mund ta japë vetëm një ligj i rishikuar si duhet, me strukturat përkatëse kontroluese e llogarikërkuese shtetërore (ndoshta në vartësi të Kuvendit, njëllor si KLSH). Kam-puset universitare duhet të shërbejnë si burime reference për shërbime shëndetësore të specializuara, nëse ato kërkohen. Staf duhet të jetë i përkushtuar dhe me përvojë në punën me studentët. Duke qenë se studentët kanë orare të papërcaktuara dhe zhvillojnë një jetë komplekse dhe shpesh stresuese, ata kanë nevojë dhe kërkesa specifike të kujdesit shëndetë-



sor. Duhet të shihet mundësia e futjes së shërbimit të kartave të shëndetit për studentët. Universitetet publike duhet të jenë të përkushtuara për të ndihmuar studentët me probleme personale, emocionale dhe psikologjike. Duhet të ketë një shërbim psikologjik që t'ju ofrohet studentëve pa kosto financiare. Shërbimi psikologjik du-

het të synojë të ofrojë këshillime afatshkurtra, terapi njohëse të sjelljes, mbështetje psikologjike dhe grupe psikopedagogjike për t'ju ndihmuar të përballoni një sërë shqetësimesh personale, emocionale dhe psikologjike. Studentët kërkojnë staf të kualifikuar, mundësisht të trajnuar edhe jashtë, jo sekretare të marra nga dekanët për të plotë-

suar qoka miqsh apo me pagesë nën dorë! Përballimi i burimeve të kufizuara financiare është një problem i përbashkët me të cilin ballafaqohen studentët. Kam-puset universitare dhe universitetet publike në tërësi duhet të ofrojnë shërbime mbështetëse ndihmuese në këtë drejtim, si këshilla financiare në menaxhimin e parave të studentëve, ap-

likimet për bursa si ndihmë financiare ndaj studentëve, bursat e ndryshme, gjetjen e burimeve të komunitetit dhe të universitetit për ndihmë financiare, si dhe punë sezonale dhe me orare të kufizuara gjatë kohës së studimeve. Shërbimi për këshillim ligjor duhet të mbështetet nga studentët të Fakultetit të Drejtësisë në universitetet publike, si dhe profesorë të këtyre departamenteve. Të gjitha këto shërbime ndaj studentëve tanë të arsimit të lartë publik do të funksionojnë si bankomate për t'u shtrëdhur abuzivisht studentëve edhe pikën e fundit të kursimeve të prindërve të tyre. Një studim i para disa muajsh i një organizate jo-qeveritare po studentësh, nxori se një pjesë e mirë e fondeve të ardhura nga tarifat e paguara prej tyre, që duhej të shkonte për kërkim shkencor dhe kushte më të mira studimi, në universitete tona publike shpenzohej për automjete dekanësh apo mobilie të shtrenjta të zyrave të tyre dhe të kancelarëve! Ja përse protesta e studentëve të arsimit tonë të lartë publik është më se e drejtë, edhe pse të gjitha paudhësitë e sistemit nuk ka arritur t'i vërë në pah.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Opinioni *i* Ditës

Zëri i Shqipërisë

Ng Liliana Hoxha

(vijon nga faqja 1)

... Janë kaq shumë të rinj ata që kanë ikur, ka kaq shumë përpjekje të të rinjve të tjerë të kërkojnë zgjidhjen e jetës jashtë vendit prej mungesës së shpresës. Shqiptarët e Shqipërisë jetojnë sot situatën më kaotike, anarkike, korruptive, mizore e kriminale. Edhe pse protestojnë, si për Teatrin Kombëtar apo për Unazën e madhe (kjo e fundit është përpjekje egzistencialiste) në mënyrën më flagrante e denigruese askush nuk ju a vë veshin. Si të kishin të bënim me shqiptarë të "llojit" ndryshe, të "llojit" të ulët nga shqiptarët e "llojit" të lartë të qeverisë e të mbështetësve të saj. Arroganca prej ironisë, miksuar hipokrizisë me modesti e elokuençë kryesisht e kryeministrit, nuk i vlen kujt, sidomos vetes së tyre, teksa mashtrojnë të tjerët, prej narcizimit vetmashtrohen gjithnjë e më shumë me performanca qesharake. Kjo që them sot është një vëzhgim i lodhur për t'u shprehur kundrejt akuzave, denoncimit, analizave, parashikimit, thirrjeve që i kam bërë ndër vite opinionit publik në media e librat e mi, ku kam theksuar: që Rama është rreziku më i madh shqiptar. Sot performancat manipulative janë gjithnjë e më të nxehta. Sikur



personi në fjalë nuk arin dot të kuptojë çdo të thotë rezistenca e "llojit" tjetër të njeriut, atij të thjeshtit për pasojë shqiptarit të ndershëm. Kam ndjekur me vëmendje studentët e sheshit dhe më bëhet zemra mal, se lëvizja e tyre deri sot nuk është bërë "pis". Nuk u bë pis as prej ftesës së neveritshme të Ramës për t'i pritur në

zyrë. Kjo do të thotë që nuk do të bëhet pis, siç u bë prej Ramiz Alisë lëvizja studentore e viteve 90. Atëherë kur u nda shapi nga sheqeri, domethënë shqiptari i pastër nga pushtetari i pistë. E pra, Shqipëria më në fund u zgjua. Studentët janë bijtë e saj, janë qelibari i qelibarit dhe kështu duhej të ndodhte.

Bërthama më inteligjente shqiptare që do të udhëheqë të ardhmen, filloi të orientojë zhvillimet e luftës për egzistencë europianiste globale që sot, si të të drejtave të njeriut, të kërkesave të mjaftueshme ekonomike e për mos cënim të dinjitetit kombëtar.

8 dhjetor 2018

HOROSKOPI

DASHI

Do ta kaloni ditën pranë familjes. Kush-tojini vëmendje familjarëve, në mënyrë që të krijoni një atmosferë të ngrohtë. Gjithashtu, bëni mirë të planifikoni se si do ta kaloni Vitin e Ri dhe se çfarë dëshironi të bëni.

DEMI

Personat e kësaj shenje mund të ndihen në ankth për të ardhmen e tyre. Ka gjasa që shkak për këtë të jetë një bisedë me partnerin/partneren tuaj. Mos i merrni për bazë të gjitha lajmet negative që iu vijnë sot.

BINJAKET

Binjakët duhet të bëjnë shumë kujdes sot, në mënyrë që të mos nxihen. Nuk duhet të nxihen as për ato veprime që ju mendojnë se jeni shumë të sigurt. Mbani veten nën kontroll dhe do të keni rezultate të kënaqshme, pavarësisht pengesave me të cilat mund të përballeni.

GAFORJA

Do të kaloni një ditë të qetë dhe do të keni mjaftueshëm kohë për t'u relaksuar. Do të bëni ato aktivitetet që dëshironi, duke dalë krejtësisht nga rutina e përditshme. Nëse keni diçka që ju shqetëson, kush-tojini vëmendjen e duhur. Ka shanse që ky problem të zgjidhet shumë shpejt.

LUANI

Do të kaloni një të shtunë të këndshme. Do t'i përkushtoheni maksimalisht vetes suaj. Do të ishte mirë të kishit bërë disa plane më parë, megjithatë gjërat do t'ju shkojnë ashtu siç dëshironi. Në mbrëmje do t'i përkushtoheni partneres/partnerit tuaj.

VIRGJERESHA

Disa persona të kësaj shenje do të jenë shumë të interesuar për librat e psikologjisë. Ka gjasa që këto njohuri t'ju duhen sot. Kjo do t'ju ndihmojë t'i lini përshypjet e duhura një personi të rëndësishëm në jetën tuaj.

PESHORJA

Do ta keni të vështirë të flini apo të qetësoheni. Disa persona do të kenë nevojë për ndihmën tuaj sot. Mos u përpuni të ndihmoni këdo, pasi çdo gjë ka kohën e duhur. Fillimisht duhet të mendoni për veten tuaj dhe të bëni plane për t'u argëtuar.

AKREPI

Është dita kur mund të shpenzoni kohën e duhur me partnerin/partneren tuaj. Do të planifikoni së bashku sesi të organizoni ditën. Personat e kësaj shenje që janë beqarë bëjnë mirë të dëgjojnë këshillat e miqve. Nëse dikush iu fton në një event, mos refuzoni.

SHIGJETARI

Përpuni të jeni sot diçka për t'u argëtuar dhe për t'u ndjerë plotësisht të kënaqur. Të njëjtën gjë sugjerojmë edhe miqve apo të afërmeve tuaj. Në mbrëmje mund të jeni pjesë e një darkë njaft të këndshme, duke e përmbyllur ditën më mirë seç mund ta kishit menduar.

BRICJAPI

Sot bricjapët mund ta gjejnë veten në një event të pazakontë. Megjithatë, përpuni të relaksoheni dhe gjërat do të ecin pozitivisht dhe do të ndihen më pak të stresuar. Kini besim tek vetja, pasi kështu do të dukeni më të besuar para partneres/partnerit tuaj.

UJORI

Kjo ditë nuk ka gjasa ta kujtoni si një ditë të veçantë. Do të vazhdoni të kryeni detyrat e lëna pas dore gjatë javës dhe do t'u përkushtoheni fëmijëve. Ndërsa beqarët e kësaj shenje rekomandohen të bëjnë kujdes për vetën.

PESHQIT

Do të kryeni aktivitete emocionuese, më së shumti të lidhura me sportet ekstreme. Nëse nuk keni qenë asnjëherë pjesë e sporteve ekstreme në të kaluarën, sot do të ndryshoni tërësisht mendim për to. Ka gjasa të niseni një lidhje të romantike.



"Topçinjtë" e kthejnë festën në skandal

Festë me femra, alkoool dhe drogë, Arsenali trondit Anglinë

Arsenali po kalon një moment mjaft të mirë në kampionatin anglez, duke qenë se nën drejtimin e Unai Emeri, ka marrë disa fitore të rëndësishme dhe po luan shumë ndryshe në krahasim me sezonet e tjera. Megjithatë, imazhi i Arsenalit ka marrë

një goditje të madhe ditën e sotme duke qenë se prestigjiozja britanike 'The Sun' ka publikuar një video nga një disko në Londër, ku shihen futbollistët e Arsenalit, të cilët festojnë në mënyrë të çmendur Rreth 70 femra, plot 30 mijë paund shpenzime me Vodka

dhe drogë, të cilën e lejon ligji në Angli, ishin pjesa e pandashme e festës së 'Topçinjeve'. Ngjarja ka ndodhur pak ditë para se të niste kampionati anglez dhe substanca e përdorur nga futbollistët e Arsenalit, është e llojit 'Hippy Crack' ku ka një përzjerje të

oksidit të azoti me lëndë të tjera. Të përfshirë në këtë festë, përveç disa futbollistëve të rinj, kanë qenë edhe Ozil, Aubameyang, Lakazet, Kolashinak. Gjendja e Ozil duket pak më e rënduar në video, aq sa nuk e mbajnë as këmbët dhe duket sikur humbet edhe ndjenjat. Vetë zëdhënësi për shtyp i 'Topçinjeve' u shpreh se kjo video do të diskutohet me futbollistët dhe të gjithë do të mbajnë përgjegjësi dhe do tu kujtohet rëndësia e fanellës.

Gafa e portierit Aldo Teqja u shfrytëzua më së miri nga Kordeiro, që shënoi nga pika e penalltisë

Kukësi thyen Skënderbeun, Cungu: Jemi ekip me karakter

Verilindorët mposhtin kampionët me rezultatin 1-0

Jeton Selimi

Kukësi mban fjalën! Thyen Skënderbeun dhe rikthehet fuqishëm në valle për titull. Verilindorët e Armando Cungut kanë arritur të triumfojnë në këtë përballje me rezultatin 1-0, ndërkaq vendosi penalltia e shndërruar në gol nga braziliani Kordeiro, një penalti që u shkaktua nga gafa e njëpasnjëshme të portierit Aldo Teqja. Mjaftoi ky episod, që skuadra që drejtohet nga Armando Cungu të merrte maksimumin e pikëve ndaj rivali direkt, duke barazuar pikërisht në kuotën e 30 pikëve Skënderbeun, që vetëm falë golaverazhit më të mirë ruan vendin e dytë.

Që Teqja nuk ishte në një ditë të mirë u pa që në minutën e 28-të, kur në tentativë për pasuar me shokët e skuadrës ia dha topin kundërshtarit, por në këtë rast goditja e Et'hemit ishte e pasaktë. Nuk munguan as momentet e tensionit, si në minutën e 57-të, kur pas një ndërhyrjeje të gabuar ndaj Dzarias, tifozët e Kukësit u irrituan, duke tentuar madje edhe të kapërcenin rrethimin mbrojtës.

Nuk ndryshoi asgjë në pjesën e mbetur të lojës, madje Cungu hodhi në fushë edhe Reginaldon, që kishte munguar në disa seanca stërvitore pas mosmarëveshjeve me drejtuesit. Fitoja e Kukësit i jep mundësi Partizanit që ta thellojë në 7 pikë diferencën me ndjekësit më të afërt, sigurisht nëse do të mund të mposhtë Teutën në "Niko Dovana".

CUNGU I LUMTUR

"Jemi në moment të mirë dhe kemi një shpirt gare dhe karakter. Nëse nuk ke karakter mungojnë shumë gjëra. Karakteri e bën edhe sistemin e lojës. Në 3 javët e fundit po bëjmë mirë. Një



sulmues duhet të shtyjë para dhe Rexhinaldo mund të dilte i vetëm para portës, por ka qenë i dëmtuar dhe prandaj nuk e futu titullar. Shpehar harxhoi shumë energji. Ka pasur shqetësime dhe ka luajtur me Kamzën në terren të vështirë, 90 minuta me Luftëtarin dhe të

bën të kesh trauma muskulore. Në mëngjes vendosmos ta sakrifikojë Rexhinaldon. Nuk kemi hyrë për t'i bërë presion askujt. I marrim ndeshjet një nga një dhe nuk shohim se çfarë ndodh pas 7 javësh", u shpreh ndër të tjera trajneri i Kukësit, Armando Cungu.

SHEHI MBRON TEQJAN

"Është një moment i vështirë. Për herë të parë në këtë kampionat vijmë pas tri ndeshjeve pa fitore. Nuk duhet të humbim besimin, duhet të vazhdojmë të punojmë dhe të luftojmë. Nuk është skuadër si vitet e mëparshme, por duhet të reagojmë. Penalltia? Një moment i evitueshëm, por unë e di mirë çfarë ndodh në ato raste, sepse kam luajtur edhe vetë portier. Kur humb topin dhe kundërshtari të vë nën presion, e humb disi toruan. Nuk duhet ta kryqëzojmë Aldon për këtë ndeshje, për mua ai është portieri më i mirë në Shqipëri. Duhet të punojmë menjëherë për ndeshjen e radhës. Duhet çdo gjë me masë, duhet ta kthejmë dhimbjen në forcë për të reaguuar dhe do të nisim punën pa bërë pushim", -deklaroi trajneri i Skënderbeut në përfundim të ndeshjes.

SUPERLIGA

Table with match schedule for Superliga: JAVA E 16-TË, Të premtën, Të shtunën, Tirana - Kastrioti, Teuta - Partizani, Kamza - Luftëtari, Flamurtari - Laçi.

RENDITJA

Table with league standings: Skuadra, N, P. Partizani (15, 34), Skënderbeu (16, 30), Kukësi (16, 30), Teuta (15, 28), Laçi (15, 26), Flamurtari (15, 22), Luftëtari (15, 13), Tirana (15, 11), Kastrioti (15, 10), Kamza (15, 9).



Progni e Beqja mungojnë, Bicaj në dyshim

Teuta ka përfunduar përgatitjet për ndeshjen e radhës me Partizanin që do ta zhvillojë në "Niko Dovana" të shtunën në orën 17:00. Kjo është një sfidë që për durrësakët vlen sa një sezon, aq më tepër që luajnë me Partizanin e vendit të parë. Fitorja me Skënderbeun u ka hapur "oreksin" durrësakëve, të cilët tashmë kanë hedhur sytë për më shumë, pse jo dhe nga vendi i parë që varet shumë nga dueli i kësaj fundjave. Por, Teuta do të ketë dy mungesa të rëndësishme ndaj partizanit dhe bëhet fjalë për dy titullarë të skuadrës së trajnerit Shkëmbi. Krahas Beqjas që u ndëshkua me karton të kuq, nuk do të jetë ditën e shtunë as një ish-i Partizanit dhe bëhet fjalë për Gerhard Prognin. Mesfushori me tipare sulmuese në sfidën ndaj Skënderbeut mori karton të verdhë. Ndërkohë në pikëpyetje është edhe qendërmbrojtësi Ditmar Bicaj. Bashkëshortja e Bicajt ka sjellë në jetë djalin e tyre dhe mbrojtësi mund të mos jetë në fushë. Megjithatë, trajneri Shkëmbi ka nisur që mendojë për ndeshjen e radhës ku do të synojë që të hedhë në fushë 11-shen më të mirë, duke qenë se tashmë nuk mungojnë alternativat në Durrës.

TRAJNERI I TË KUQVE SULMON FEDERATËN

Gega: Nuk e dija që e paskan kaq frikë Partizanin




Skënder Gega, trajneri i Partizanit ka dalë dje para mediave në prag të takimit që skuadra e tij luan në transfertë ndaj Teutës. I revoltuar në lidhje me dënimin që Disiplina i ka dhënë tifozëve, Gega është shprehur se të gjithë e kanë frikë Partizanin, madje dhe se po mundohen që ta pengojnë. "Ndeshja me Teutën? Është ndeshje si gjithë të tjerat. Kemi edhe 2 ndeshje para se të mbarojë gjysma e kampionatit. E shohim si të radhës dhe është e fortë. Këtë ndeshje shkojmë vetëm për të fituar. Tifozët? Na kënaq dhe më bëhet qefi që në çdo stadium të jetë i mbushur pasi nxitemi më shumë dhe kënaqemi. Nuk jep presion. E dua stadiumin plot

edhe kundër nesh. Unë i bëj thirrje tifozëve këtu që të mos tërhiqen edhe pse nuk e dija që e paskan kaq frikë Partizanin. Nuk e

rëndësishme. Durrësi është afër dhe luajmë në shtëpinë tonë. "Ultras Guerrils" janë lojtari ynë i 12 dhe me këtë jetë që është në Shqipëri, ata i japin bukuri stadioneve. Në derbi tifozët u sollën shumë mirë dhe i dhanë atmosferë derbit edhe pse kundërshtarët nuk ishin. Pa tifozë është bosh. Shpresoj të ndryshojmë gjërat deri me Kukësin. Nuk është dhunë pse përqafon futbollistin. Dhunë është kur ndërpret ndeshjen, sulmon arbitrin ose futbollistët, por jo të përqafosh dikë. Ai u fut dhe iku për 30 sekonda. Klubi ka guhën e vet se si do të ankohe dhe do të gjëje të drejtën e tyre. Nuk e dija që e kanë

dija që duan ta pengojnë me çdo rrethanë. Jemi në gjendje të mirë me lojtarët dhe tifozët. Jemi familje. Nuk kam premtuar as fitore dhe as titull, por do të shohim vetëm nga ndeshja e radhës për të fituar. Ndryshim politikash me FSHF? Nuk duhet të merret sjella e mirë dhe profesionalizmi si dobësi dhe modesti. Ne po mendohejmë të japim shembullin e mirë brenda dhe jashtë fushë dhe duam të japim një mesazh të mediave dhe kudo si nivel i lartë profesionalizmi, por nëse kjo e shqetëson FSHF-në, dhe do të sillim ndryshe, nuk është problemi ynë dhe i dikujt tjetër. Asnjë lloj politike, por bëjmë punën tonë", u shpreh ndër të tjera Gega.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë kursimi
5. Një luhet nga banda
8. I kanë tek poret.
11. Është konfuzion i madh.
13. Ndriqet me barna.
14. Ngrihet me doli
17. Janë në skaje.
18. Ai dhe ajo.
19. Mund të jenë celularë.
21. Mund të klasifikohen në ATP.
22. Fillojnë hapur.
24. Janë mbulesa... mbi hambarë.
27. Mund jenë fetare.
28. Është edhe ai shiatic.
29. Fillojnë sefte.
31. Një këshilltar për negus.
32. Ishte zonjë romake.
36. Është rebelim.
39. Liam i Schindler's list.

40. Në krye të klasifikimit.
41. Oliver që qe aktor.
42. Inicialet e Depardieu.
43. Centrale Rajonale Tiranë.
44. Muhamad i ringut.
46. Gjysma e arenës.
48. Pret fëmijë një e tillë.
49. Nuk ka harbuti
50. Dickinson poete.
51. I ka të ndryshme një trakt

VERTIKAL

1. Fillojnë aktivitetin.
2. Një mund të jetë i rrallë.
3. Më e mira është rekord.
4. Haset pa kufij.
6. Marco, portier italian.
7. Jonathan i Gulliver
8. Nuk i pëlqen dembelit.
9. Mund të jenë ciklistike të tilla.
10. Gjysmë tati.
12. Mund të jenë kohore.
13. Mund të jenë ndërtimi dhe detare të tilla.
15. Bën ura të arta të tillë.
16. Një provë.
18. Gjysmë arkivi.
20. Christian i fushës magnetike.
21. Një mund të ishtrohet edhe psikologjik.
23. Është pakti ku aderojmë.
25. Mbyllin krahun.
26. Fillojnë vetëm.
30. Mund të jenë edhe ambalazhi.
33. Në mes të Miguel edhe Asturias.
34. Emri i Wilde.
35. Opera e Bellini-t.
37. Fitzgerald këngëtare.
38. Smith Filozof.
45. Diku në qendër.
47. Fund janari.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Është për medaljen e parë.
5. Një tip... kërcimi.
7. Mula këngëtare lirike.
11. Nuk di të tradhtëojë.
13. Një ndalim... edhe shtëpie .
15. Inicialet e Delon.
16. Një shpërblim në para .
18. Ishin 12 ato të Herkulit.
20. Fillojnë detyrën.
21. Një është i ndaluar në kthesë.
23. Gjysmë fatale.
24. Është figurë letrare.
26. Burton regjisor
27. Pal likantropi.
29. Ente Ekonomike Autonome.
30. Gjysmë stoike.
32. U printe hunëve.
34. Ndërmarrje Ndërkombëtare Transporti.

VERTIKAL


1. Tabak pa kufij.
2. Dridhen pa dhen.
3. Fise pa fe.
4. Janë reaksionet në provëza
5. Është kujdes për të miturin
6. Është princip.
7. Me dies në liturgji.
8. Ngelur pa gur
9. Kufijtë e vetes.
10. Është e lehtë në meeting
12. Janë kabina detarësh
14. Një mund të jetë edhe fetar.
17. Emri i parë i Remarque.
18. Nuk tuten.
19. Rastet pa set.
20. Inicialet e Argento regjisor.
21. Janë dëshmi shoferësh.
22. Janë uft.
23. Ishin fjalimet e Demostenit.
25. Është topi në rugby.
28. Ishin të orarët tanë.
30. Një vend nisjeje.
31. Lumë në Rusi.
33. Jepet për hartim.
36. Është elitë... e shoqërisë.
37. Mbreti i Cordelia-s.
39. Kufizojnë një studim.
40. Rrafiaruar pjesërisht
42. Botim pa kufij.
43. Mbetet në fund.
45. Fillojnë panikun



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	1		8	6		7	9	
			3			4	2	6
4	5			7		8		
				5	8	2		
9		5				1		8
		2	7	9				
	7		4				1	3
6	4	9			1			
8	3		2	6				5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	6	3	9	7	1	4	8	5
9	5	7	4	2	8	6	1	3
4	1	8	6	3	5	7	9	2
8	7	5	1	4	3	9	2	6
3	4	1	2	6	9	5	7	8
6	9	2	5	8	7	1	3	4
1	3	6	7	5	2	8	4	9
5	8	9	3	1	4	2	6	7
7	2	4	8	9	6	3	5	1

Argëtim filozofik

-Zotat na kanë dhënë dhuratën më të madhe: ne mund ta krijojmë realitetin tonë bazuar në besimet tona dhe kufizimi i vetëm është ai në të cilin ne besojmë.

-Le t'i jemi mirënjohës pasqyrës që zbulon vetëm pamjen tonë të jashtme.

-Singëriteti dëbon të shumtët, por mban të drejtët.

-Nuk është se çfarë thonë për ty, por çfarë pëshpërisin.

Realiteti është një iluzion kolektiv.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

15	G	A	T	I		2	4	6	3	10	2	4
1	7	1	8		11	1	12	2	3	7	7	
7	3	2		13	3	11	1	2	4	2	4	2
15	17		13	3	7	3	2	4	5	3		
1		5	9	8	4	2	3	2	3	2	8	
9		3	5	4	11	3	2	2	2	5	1	
3	4	16	10	3	2		5	1	11	1	5	
6		4		15	16		17	2	4	6	3	
6	7		17	20	4	10	15			17	4	2
1	9		11	1	2	3	10	2	1	2		
	8	1		19	3		9	7	1	7	4	
15	19	11	4			11	9	6	4	2	4	5

R	O	M	A	N	C	I	E	R	E	T	C	
I	R	O	N	L	I	E	R	E	T	R	U	P
T	R	T	A	R	T	A	R	E	T			
K	A	M	E	R	I	E	R	E	T	U		
D	E	L	I	R	A	N	T	E	T	P	R	
C	T	A	B	O	R	A	T	A				
K	R	I	P	E	A	O	L	E				
S	L	O	I	L	P	R	A	U	L			
T	A	N	T	A	L	I	U	R	R	A		
U	S	R	E	K	I	P	I	T	E			
F	A	T	A	L	A	L	I	E	N	E	T	
E	T	A	P	A	T	K	A	T	E	T	I	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	T	M	L	T	R	A	J	T	A	T		
P	L	K	A	P	A	L	I	E	N	E		
R	E	K	O	R	D	E	T	P	M	T	R	
I	A	N	S	A	M	B	L	I	H	E	M	
I	M	A	R	T	I	N	D	E	N	I	N	
O	H	A	R	A	T	T	I	T	A	R	A	
E	P	B	A	N	A	P	I	S	H	E	I	
E	P	I	T	E	T	E	T	Y	E	S	T	
M	T	N	A	T	N	A	I	I	M	A	R	
I	K	A	A	K	R	I	M	A	R	A	T	
L	A	P	A	R	A	R	O	J	A	T		
E	T	I	K	A	S	E	N	A	T	O	R	
K	A	A	S	L	U	L	I	M	A	T	A	
A	R	R	A	S	B	A	R	N	U	M	R	
L	A	T	A	B	R	O	A	E	F	I		
L	E	L	E	M	E	N	T	A	R	E	I	
A	N	E	T	A	R	E	S	T	A	T	N	
M	I	N	I	M	A	L	E	K	O			
I	K	L	I	T	A	R	T	E	M	A		
E	S	E	N	I	N	E	R	I	E	R		
P	A	N	A	I	M	E	K	N	I			
E	T	N	I	E	M	I	N	E	M	A		
L	O	T	A	S	D	R	I	T	A	T		
A	L	A	I	N	E	M	I	S	A	R	E	T

FJALËKRYQI (1)
FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Shumica e njerëzve nuk kanë mësuar kurrë se një nga qëllimet më të rëndësishme të jetës, është që ta shijosh atë.
- Ndonjëherë logjika është një çështje statistikash.
- Sytë kurrë nuk ndryshojnë ngjyrën, vetëm mënyrën e shikimit.
- "Feja ime kërkon që para jeta të zbrisë këtu në tokë në mënyrë që të gjithë të mund të shijojnë atë"

